



GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE

Raporti Vjetor i Performancës

2025

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE	6	VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE	54
STRUKTURA E GJYKATËS SË LARTË	12	Qendra e Dokumentacionit	54
Trupa gjyqësore.....	12	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë	60
Njësia e Shërbimit Ligjor	14	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve	66
Burimet Njerëzore	14	Drejtoria e Administrimit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.....	68
VEPRIMTARIA GJYQËSORE	16	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë	70
Veprimtaria e Gjykatës së Lartë në gjuhën e statistikave	26	Drejtoria e Administrimit Gjyqësor	73
Çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë	26	PËRFUNDIME	75
Çështjet e gjykuara në Gjykatën e Lartë	28		
Çështjet e gjykuara në raport me çështjet e regjistruara.....	29		
Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Gjyqtar.....	45		
Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Njësinë e Shërbimit Ligjor.....	46		
Çështjet e mbartura dhe çështjet e prapambetura (backlog/stok)	47		
VEPRIMTARIA E ORGANEVE DREJTUESE	52		
Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve.....	52		
Këshilli i Gjykatës	52		
Kryetari i Gjykatës.....	53		
Kancelari	53		

“E vërteta nuk bërtet, ajo qëndron.”

Në respekt të gjyqtarit

ASTRIT KALAJA

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E GJYKATËS SË LARTË 2025

PËRMBLEDHJE

Viti 2025 ishte një ndër më sfiduesit për Gjykatën e Lartë, i shënuar nga ngjarje të jashtëzakonshme, si dhe nga motivimi i vazhdueshëm për forcimin e besimit të qytetarëve te drejtësia. Në këtë panoramë të ndërlikuar, Gjykata e Lartë qëndroi e palëkundur në misionin e saj kushtetues, duke ushtruar kompetencat me integritet, paanshmëri dhe profesionalizëm. Pavarësisht sfidave që prekën themelet e sistemit të drejtësisë, institucioni mbeti garant i zbatimit të ligjit, duke dëshmuar se drejtësia e qëndrueshme ndërtohet mbi parime, jo mbi rrethana. Ky raport vjetor pasqyron përpjekjet dhe vendimmarrjet që e shoqëruan këtë vit gjatë të cilit Gjykata e Lartë e përmbushi detyrën e saj me përgjegjësi dhe dinjitet, duke kontribuar në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në ruajtjen e integritetit institucional.

Vrasja tragjike e gjyqtarit Astrit Kalaja

Me keqardhje të thellë, raporti vjetor i këtij viti hapet me një ngjarje të rëndë kriminale, e cila tronditi sistemin e drejtësisë dhe opinionin publik: humbjen e kolegut tonë, gjyqtarit Astrit Kalaja, i cili u vra gjatë ushtrimit të detyrës, duke dhënë drejtësi “*Në emër të Republikës*”. Ky akt i rëndë përbën një sulm të drejtpërdrejtë ndaj shtetit të së drejtës, një cenim serioz të pavarësisë së gjyqësorit dhe një goditje të paprecedent ndaj autoritetit dhe dinjitetit të figurës së gjyqtarit. Kjo humbje tragjike, e ndodhur në kryerje të funksionit kushtetues, do të

mbetet një dëshmi e përhershme e sakrificës, integritetit dhe përkushtimit ndaj detyrës. Ne, gjyqtarët, duhet të nderojmë veprën dhe kontributin e gjyqtarit Kalaja duke u përpjekur në maksimum të forcojmë sistemin gjyqësor, për ta bërë atë më të sigurt, më të pavarur dhe më të drejtë, në shërbim të qytetarëve.

Menjëherë pas kësaj ngjarje tragjike, Kryetari i Gjykatës së Lartë, në ushtrim të përgjegjësiwe institucionale, thirri në një mbledhje të veçantë të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë, e cila u zhvillua më datë 9 tetor 2025, në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në përfundim të mbledhjes, gjyqtarët miratuan “*Deklaratën e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë*” në të cilën u shpreh vendosmëria për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe garantimin e sigurisë së trupës gjyqësore, duke kërkuar veprim të menjëhershëm institucional për kapërcimin e krizës së thelluar të sigurisë dhe kushteve të ushtrimit të funksionit gjyqësor. Gjyqtarët theksuan nevojën për masa urgjente, përfshirë ngritjen e strukturave të posaçme ndërinstitutionale, hartimin e platformave kombëtare të sigurisë, pajisjen e gjykatave me mekanizma mbrojtës dhe ndërhyrjet e domosdoshme ligjore e nënligjore për garantimin e mbrojtjes fizike, profesionale dhe institucionale të gjyqtarëve. Ata kërkuar gjithashtu që Këshilli i Lartë Gjyqësor të ushtrojë me vendosmëri mandatin e tij kushtetues, ndërsa Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave të marrin përgjegjësinë për përmirësimin struktural dhe logjistik

1. Deklarata e plotë: *Deklarata e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë*

të sistemit gjyqësor. Krahas kësaj, u shprehën angazhime të qarta morale dhe profesionale për rritjen e cilësisë së gjyimit, forcimin e integritetit dhe ruajtjen e standardeve të larta të paanshmërisë dhe etikës gjyqësore, ndërsa në nderim të gjyqtarit të rënë u kërkuar njohja e statusit “*Dëshmor i Atdheut*” dhe përjetësimi i figurës së tij në institucionet gjyqësore. Në këtë kontekst, deklarata paraqet një thirrje të qartë për veprim dhe përgjegjësi, duke theksuar se mbrojtja e gjyqtarit është kusht themelor për mbrojtjen e drejtësisë dhe të qytetarit.

Zgjedhja e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

Gjatë vitit 2025 u zhvillua procedura për zgjedhjen e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata e Lartë, bazuar në renditjen e kandidatëve të bërë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Pas përfundimit të procesit të pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1, datë 25.09.2025, vendosi thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Në datën 30.09.2025, u zhvillua Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku morën pjesë 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke plotësuar kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Në përfundim të procesit të votimit, në kushtet kur asnjëri prej kandidatëve nuk arriti të sigurojë shumicën e votave të nevojshme, kandidati i renditur i pari në listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të hartuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, u konsiderua *ipso lege* i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë vendosi zgjedhjen e z. Asim Vokshi anëtar të Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9-vjeçar.

Procesi vendimmarrës

Edhe gjatë vitit 2025, Gjykata e Lartë ka vijuar të japë kontributin e saj në ofrimin e një drejtësie cilësore në shërbim të qytetarëve. Në këtë kuadër, ajo ka konsoliduar rolin e saj si një partner i besueshëm në procesin e administrimit të drejtësisë, duke garantuar një përdorim profesional, efikas dhe të përgjegjshëm të burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion, në funksion të përmbushjes së misionit të saj kushtetues.

Gjykata e Lartë ka vijuar përpjekjet për realizimin e misionit kushtetues të dhënies së drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes gjyqësore cilësore, duke u përqendruar në interpretimin e njëzuar të ligjit dhe në garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtësisë. Nëpërmjet veprimtarisë gjyqësore dhe ushtrimit të funksionit të saj nomofilatik, Gjykata e Lartë, përmes një interpretimi konstant, të konsoliduar dhe autoritativ të normave juridike, ndërton një korpus vendimesh gjyqësore që përbën të ashtuquajturën “*e drejtë e gjallë*”. Ky korpus formëson dhe orienton praktikën gjyqësore, duke u bërë pjesë integrale e sistemit juridik dhe duke siguruar një zhvillim harmonik dhe të balancuar të së drejtës, në përputhje me kushtet aktuale socio-ekonomike të shoqërisë dhe me dinamikën e sistemit të vlerave shoqërore.

Konkretisht veprimtaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë në vitin 2025 u karakterizua nga një përmirësim progresiv i situatës lidhur me numrin e lartë të çështjeve gjyqësore të prapambetura. Procesi i uljes së stokut vijon të jetë konstant duke ruajtur gjithashtu ritmin për gjykimin e çështjeve urgjente. Gjatë vitit 2025, Gjykata e Lartë dha në total 6876 vendime gjyqësore, ndërsa numri

i çështjeve të prapambetura tashmë përbëhet nga 14,081 çështje gjyqësore. Për krahasim, në vitin 2024, Gjykata e Lartë dha në total 7639 vendime gjyqësore, ndërsa stoku me çështje të prapambetura përbëhej nga 18,619 çështje gjyqësore. Këto të dhëna statistikore janë rezultat i përpjekjeve të jashtëzakonshme të Gjykatës së Lartë për të reduktuar vonesat e akumuluar dhe përfaqësojnë tregues objektivë pozitivë. Ato shërbejnë si një nxitje e mëtejshme për të vazhduar me të njëjtin ritëm në të ardhmen, duke mundësuar normalizimin e situatës dhe përshtatjen e saj me standardet dhe parametrat e përcaktuar në rekomandimet e CEPEJ.

Trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë në fund të vitit 2025 ka 15 gjyqtarë efektivë. Në muajin nëntor 2025 trupa u zvogëlua me 1 (një) gjyqtar si pasojë e zgjedhjes së tij si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa 1 (një) gjyqtar tjetër, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk ka mundur të ushtrojë detyrën në mënyrë efektive. Ndërkohë 1 (një) vend vakant i krijuar në vitin 2024 ende nuk është plotësuar nga KLGJ. Në këto kushte zvogëlimi i kapaciteteve gjyqësore në Gjykatën e Lartë meriton vëmendje të shtuar, pasi trupa gjyqësore aktualisht përballet me një ngarkesë të shtuar që ka sjellë pasojë në rendimentin dhe efikasitetin e punës. Mungesa e gjyqtarëve sipas shkaqeve të mësipërme detyroi Gjykatën e Lartë të merrte masa organizative për rishpërndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve efektivë, gjë e cila solli vështirësi në drejtim të organizimit dhe funksionimit të trupave gjyqësore, shtimit të volumit të ngarkesës individuale të gjyqtarëve dhe të planifikimit të çështjeve gjyqësore. Megjithatë, u arrit të garantohej një stabilitet i pranueshëm për sa i përket efikasitetit të gjyqësorisë së çështjeve dhe evadimit të stokut të dosjeve. Referuar këtyre zhvillimeve rezulton se gjatë vitit 2025 ngarkesa për çdo gjyqtar të Gjykatës së Lartë ka qenë mesatarisht 404 çështje.

Pavarësisht rezultateve pozitive, në kuadër të evadimit të çështjeve të prapambetura si dhe të gjyqimit të çështjeve emergjente, një faktor kyç për funksionimin në mënyrë efikase të Gjykatës është kapaciteti i burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara. Për vitin 2025 janë konstatuar ende mungesa në Njësinë e Shërbimit Ligjor, ku shërbejnë 30 këshilltarë ligjorë prej të cilëve 11 janë ndihmësmagjistratë dhe 19 janë këshilltarë ligjorë nga 38 që parashikon organika. Për vitin 2025, organika e Njesisë së Shërbimit Ligjor u plotësua me 5 (pesë) ndihmësmagjistratë. Sfidë për vitin 2026 do të jetë plotësimi i 8 (tetë) vakancave në Njësinë e Shërbimit Ligjor, me ndihmësmagjistratë të komanduar nga KLGJ, sipas vendimit nr.1, datë 12.09.2024 të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga magjistratë të komanduar, këshilltarë jo-magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës apo këshilltarë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, ka kontribuar në rritjen e cilësisë së analizës dhe kërkimit juridik, harmonizim më të mirë të praktikës si dhe përmirësim të vendimmarrjes gjyqësore. Paralelisht me vijueshmërinë e plotësimit të vakancave në Njësinë e Shërbimit Ligjor pritet një rritje e volumit të çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Lartë.

Në tërësi, nga viti 2020, organika e Gjykatës së Lartë është zgjeruar gradualisht, në përpjekje për t'iu përgjigjur rritjes së vazhdueshme të ngarkesës së gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë, si dhe stafit administrativ. Ndryshimet në formacionet e trupave gjyqësore si rezultat i vakancave apo kushteve të tjera janë përballuar me praktika organizative që kanë synuar zgjidhjen e tyre. Edhe pse masat administrative dhe institucionale të ndërmarra për të siguruar një organizim

më të mirë dhe më efikas të punës kanë sjellë rezultate shumë pozitive në aspektin sasior të evadimit të çështjeve gjyqësore, Gjykata vazhdon të përballtet me realitetin e punës nën presion për uljen e stokut dhe me ngarkesë të lartë, me kushte pune jo të përshtatshme, të cilat ndikojnë në arritjen e nivelit të dëshiruar cilësor të veprimtarisë gjyqësore. Shifra e ulur ndjeshëm e stokut, në 14,081 çështje gjatë një periudhe kur Gjykata e Lartë ka funksionuar me përbërje jo të plotë tregon për situatën e pazakontë në të cilën është vijuar të punohet edhe këtë vit në institucion.

Në përputhje me kuadrin ligjor, Gjykata e Lartë është e organizuar në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. Këshilli i Gjykatës së Lartë, pas mendimit të dhënë nga Mbledhja e Gjyqtarëve², ka miratuar aktet përkatëse për ndarjen e gjyqtarëve sipas kolegjeve përkatëse, duke marrë për bazë dhe fushën ku është emëruar gjyqtari nga KLGJ. Janë krijuar disa trupa gjyqësore brenda kolegjeve, të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë. Gjithashtu, në përputhje me rregullat e organizimit gjyqësor si dhe në funksion të koordinimit dhe menaxhimit më efikas të veprimtarisë gjyqësore mes gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë, kolegjet kanë zgjedhur kryetarët e tyre për vitin 2025.

Pavarësisht përkatësisë së gjyqtarit në një kolegji të caktuar, për nevoja të punës dhe për të përballuar situatën e krijuar, sidomos në Kolegjin Civil, që funksionon me kapacitet të reduktuar për shkak të mungesave të gjyqtarëve dhe vakancave të krijuara, gjyqtarë të një kolegji tjetër marrin pjesë në trupa gjyqësorë të Kolegjit Civil.³ Kështu, në përbërje të Kolegjit Administrativ janë 5 (pesë) gjyqtarë, të cilët

janë ndarë në 2 (dy) trupa gjykuese të përbërë me 3 (tre) gjyqtarë. Në përbërje të Kolegjit Civil janë 7 (shtatë) gjyqtarë, të cilët janë të ndarë në 3 (tre) trupa gjykuese të përbërë me 3 (tre) gjyqtarë. Në përbërje të Kolegjit Penal janë 5 (pesë) gjyqtarë, të cilët janë të ndarë në 2 (dy) trupa gjykuese të përbërë me 3 (tre) gjyqtarë. Aktet e Këshillit të Gjykatës për miratimin e ndarjes së gjyqtarëve në trupat gjykuese janë publikuar menjëherë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë për njohje nga publiku dhe mbi bazën e kësaj ndarje është zhvilluar dhe shorti për caktimin e çështjeve gjyqësore sipas kompetencës lëndore.

Vijon të mbetet shqetësim cilësia e rekurseve të paraqitura në Gjykatën e Lartë nga të gjithë subjektet (avokatë, avokatë të shtetit, prokurorë). Me gjithë ndryshimet kushtetuese e ligjore dhe përpjekjet e rëndësishme të bëra gjatë këtyre viteve të fundit, lidhur me rolin dhe funksionin e Gjykatës së Lartë në sistemin gjyqësor, me keqardhje vihet re ende se Gjykata e Lartë perceptohet si një “shkallë e tretë themeli”. Kjo konstatohet jo vetëm nga numri i lartë i pajustificuar i rekurseve drejtuar Gjykatës, por edhe nga cilësia e dobët, që çon në mospranimin në shkallë të lartë të tyre, madje në fazën fillestare përmes kolegjit seleksionues. Konkretisht, në veprimtarinë e tij seleksionuese, Kolegji Administrativ ka vijuar me shqyrtimin paraprak të rekurseve të paraqitura gjatë vitit 2025, nga të cilat 35% e rekurseve të regjistruara nuk u pranuan, si haptazi të pabazuara. Jo rrallë konstatohet një konfuzion në lidhje me identifikimin e qartë të pretendimeve, artikulimin e saktë dhe koherent të shkaqeve të rekursit, si dhe argumentimin e pamjaftueshëm ligjor në një numër të konsiderueshëm rekursesh. Këto mangësi, që përbëjnë shkelje të rregullave procedurale për paraqitjen e shkaqeve të rekursit, e detyrojnë Gjykatën e Lartë të angazhohet në

2. [Vendimi nr. 6, datë 21.03.2024](#); [Vendimi nr. 6, datë 21.03.2024](#)

3. [Vendimi nr. 10, datë 27.06.2025](#); [Vendimi nr.10 datë 27.06.2025](#); [Vendimi nr.15, datë 10.10.2025](#);

[Vendimi nr.15 datë 10.10.2025](#)

një proces filtrimi/përzgjedhjeje, duke shpenzuar burime njerëzore dhe kohë të çmueshme, e cila mund të përdoret për çështje të rëndësishme që i vlejné njësimi apo zhvillimit të praktikës gjyqësore.

Në këto rrethana, lind nevoja për iniciimin e një procesi të përbashkët diskutimi dhe reflektimi, përmes vendosjes së një dialogu të hapur dhe konstruktiv me subjektet proceduralë. Ky proces synon rritjen e përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rolin që ata luajnë në administrimin e drejtësisë, si dhe mbi rolin dhe misionin e Gjykatës së Lartë për ta udhëhequr këtë dialog të rëndësishëm për forcimin e rolit të saj në kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallëve më të ulëta.

Në aspektin infrastrukturor, situata lidhur me sigurimin e kushteve dhe mjediseve të përshtatshme të punës ende nuk ka ndryshuar. Ambientet e punës së Gjykatës së Lartë paraqiten të pamjaftueshme për numrin aktual të gjyqtarëve dhe stafit administrativ. Kushtet e punës vazhdojnë të jenë jo të përshtatshme dhe aspak komode, me zyra ku punojnë disa punonjës jashtë standardeve të raportit midis hapësirës dhe numrit të punonjësve. Problematika e sistemimit të dosjeve gjyqësore në mjediset e Gjykatës ende mbetet e pazgjidhur. Një e pjesë e dosjeve është sistemuar në ambientet e KLGJ-së të vëna në dispozicion për këtë qëllim dhe stafi i Gjykatës detyrohet të lëvizë çdo ditë për transportin e tyre. Pas ngjarjes tragjike të vrasjes në krye të detyrës të gjyqtarit, z. Astrit Kalaja, Gjykata e Lartë përforcoi menjëherë masat e sigurisë, me qëllim parandalimin e incidenteve apo rreziqeve të ngjashme në të ardhmen si dhe krijimin e një mjedisi të sigurt në mjediset e saj për të gjithë stafin dhe publikun.

Në vijim, Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj nomofilatik, ka shqyrtuar në këtë vit çështje të rëndësishme ligjore, duke përcaktuar parime juridike me rëndësi për të drejtat themelore të njeriut, për çështje të natyrës ekonomiko-shoqërore të qytetarëve dhe sipërmarrjeve, për ligjshmërinë e akteve apo veprimeve të administratës, duke u përpjekur që të sigurojë një stabilitet dhe uniformitet në orientimet e praktikës gjyqësore. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë, në vitin 2025, ka marrë 4 vendime njësuere si dhe ka shpallur për njësim çështje të tjera.

Një mision i rëndësishëm i Gjykatës së Lartë është dhe shpërndarja e informacionit juridik me qëllim njohjen e jurisprudence së saj. Në këtë kuadër, Qendra e Dokumentacionit ka vijuar detyrën e saj përmes përgatitjes dhe publikimit të buletinit periodik dhe tematik të vendimmarrjes gjyqësore, duke identifikuar orientimet kryesore, pozicionet doktrinare dhe linjat zhvillimore të jurisprudence që përbëjnë ushtrimin e nomofilakisë nga ana e Gjykatës. Maksimat e përfshira në buletin janë rezultat i një përzgjedhjeje të kujdesshme dhe paraqesin konceptin juridik të Gjykatës së Lartë si konkluzion i gjykimit që ajo zhvillon në çdo rast. Publikimi i vendimmarrjes me *metadatat* përkatëse të përgatitura nga Qendra e Dokumentacionit mundëson kuptimin sa më të qartë të koncepteve juridike dhe trajtimit doktrinar të çështjeve ligjore me qëllim orientimin e jurisprudence, duke shërbyer si pikë referimi për komunitetin juridik lidhur me zhvillimin e mëtejshëm profesional të tij.

Databaza e ngritur nga Gjykata e Lartë dhe e administruar nga Qendra e Dokumentacionit, JUDIX, për të dytin vit po dëshmon se kjo Gjykatë e ka në fokus lehtësimin për kërkimin e vendimeve gjyqësore nga përdoruesit,

brenda dhe jashtë Gjykatës. Që nga lancimi i platformës e deri në fund të këtij viti, ka vijuar në mënyrë intensive puna për popullimin e saj, ku sot numërojnë mbi 2000 vendime të Gjykatës së Lartë, ndër vite. JUDIX u jep mundësinë të gjithë përdoruesve të saj, që të njihen me vendimet e përpunuara, duke i kërkuar përmes palëve, fjalëve kyçe, titullit të vendimit, bazës juridike, numrit të vendimit, datës së vendimit, gjyqtarit relator, maksimës apo përmbledhjes.

Për vitin 2025 vijoi tradita e botimit të *Vendimeve Njësuese të Gjykatës së Lartë* me një përmbledhje të vendimeve të përzgjedhura nga të gjitha Kolegjet përgjatë viteve 2021–2024. Ky botim i ri, i mundësuar nga mbështetja e vazhdueshme e Këshillit të Evropës, është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të konsoliduar jurisprudencën kombëtare dhe për të kontribuar më tej në harmonizimin e praktikës gjyqësore në Shqipëri. Duke bërë bashkë të gjitha vendimet njësuere dhe ato ndryshuese të nxjerra nga Gjykata e Lartë gjatë kësaj periudhe, botimi synon të mbështesë interpretimin dhe zbatimin sa më të qëndrueshëm të legjislacionit në të gjithë sistemin gjyqësor, duke rritur kështu sigurinë juridike, efikasitetin gjyqësor dhe zbatimin e shtetit të së drejtës. Risi e botimit të këtij viti është edhe përkthimi i përmbledhjes së vendimeve në gjuhën angleze me qëllim njohjen e praktikës nga lexues e studiues të huaj.

Një aspekt me rëndësi për konsolidimin e rolit të Gjykatës së Lartë si një aktor aktiv dhe kontribuues në debatin ndërkombëtar mbi sfidat dhe zhvillimet në fushën e drejtësisë, njëkohësisht bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shkëmbimin e përvojave me sisteme të tjera ligjore, ka qenë pjesëmarrja me një delegacion të gjerë në Kongresin Botëror të Ligjit në Santo Domingo, Republika Domenikane, më 4–6 maj 2025. Gjatë këtij aktiviteti, delegacioni i Gjykatës së Lartë, i kryesuar

nga Kryetari i saj, dhe i përbërë nga gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë kontribuan aktivisht në disa panele të Kongresit, duke prezantuar përvojën dhe zhvillimet e sistemit shqiptar të drejtësisë. Përmes kësaj pjesëmarrje, Gjykata e Lartë afirmoi edhe angazhimin për bashkëorganizimin e Kongresit Botëror të Ligjit në vitin 2027 në Tiranë. Ky event i rëndësishëm për drejtësinë vendos Shqipërinë në qendër të vëmendjes së aktorëve juridikë nga e gjithë bota.

Një moment tjetër kulmor i këtij viti shënoi dhe rikthimi në Shqipëri për herë të dytë pas 10- vitesh i Konferencës së Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në datat 9-10 Qershor, në Vlorë, Gjykata e Lartë, së bashku me Institutin CEELI, organizoi tryezën e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të rajonit, ku morën pjesë 11 delegacione. Punimet e Konferencës sollën shkëmbimin e ideve lidhur me administrimin e gjyqësorit në dritën e sfidave të kohëve moderne.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, në vitin 2025, Gjykata e Lartë bëri prezantimin e rubrikës *Open Data*. Rubrika përmban informacion në lidhje me të dhëna statistikore për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, raporte vjetore të performancës së Gjykatës së Lartë, informacion mbi veprimtarinë e Këshillit të Gjykatës, Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve, Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Gjithashtu rubrika përmban ndërlidhje për video informuese mbi përdorimin e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, anketime të ndryshme mbi veprimtarinë e gjykatës, të dhëna me natyrë buxhetore, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, fjalime dhe intervista të Kryetarit, buletinët e vendimeve gjyqësore si dhe formularët e informimit/ankesave në kuadër të të drejtës për informim.

STRUKTURA E GJYKATËS SË LARTË

Trupa gjyqësore

Organika e Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Lartë për vitin 2025 është si vijon:

Periudha	janar – mars 2025	prill – korrik 2025	gusht – dhjetor 2025
Numri i gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në Gjykatë	17 ⁴	16 ⁵	16

Pas riorganizimit të kolegjeve dhe trupave gjykuese nga Këshilli i Gjykatës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës, është rihedhur shorti për caktimin e çështjeve, sipas rregullave të miratuara nga KLGJ dhe aktualisht, 17 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë janë të ndarë në kolegje dhe trupa gjyqësorë si më poshtë:

Kolegji Administrativ – 5 gjyqtarë, Kolegji Civil – 7 gjyqtarë, Kolegji penal – 5 gjyqtarë

4. Për këtë periudhë gjyqtari K. Kurushi nuk ka qenë pjesë efektive për shkak të angazhimit si anëtar i KLGJ. Është deklaruar përfundimi i mandatit të gjyqtarit të ndjerë, D. Sina, sipas vendimit nr. 2, datë 20.11.2024. Me vendimin nr. 3, datë 26.11.2025, është deklaruar përfundimi i mandatit të gjyqtarit A. Vokshi, si rezultat i emërimit të tij në Gjykatën Kushtetuese.
5. Përgjatë muajve prill-dhjetor ka munguar gjyqtarja V. Kola për arsye shëndetësore.

Kolegji Administrativ

Grupat e përhershme	
Trupi Gjykues 1	Trupi Gjykues 2 ⁶
Sokol Sadushi Sokol Ngresi Gentian Medja	Asim Vokshi Arbena Ahmeti Enkelejda Metaliaj
Nga Dhjetori 2025 në këtë trupë do të gjykojë <i>Sokol Ngresi/ Gentian Medja.</i>	

6. Me përfundimin e mandatit të gjyqtarit A. Vokshi, më datë 26.11.2025, Këshilli i Gjykatës me anë të vendimit nr. 16, datë 27.11.2025, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024, “Për caktimin e Gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit Kolegji” vendosi se, për çështjet administrative që janë planifikuar të shqyrtohen në muajin dhjetor 2025 e në vijim, rendi i shqyrtimit të tyre nga Trupi Gjykues nr. 2, është sipas skemës si vijon:
- a) për çështjet e planifikuara në ditët që bien në javët tek të muajit, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Sokol Ngresi;
- b) për çështjet e planifikuara në ditët që bien në javët çift të muajit, në përbërje të trupit gjykues do të jetë gjyqtari Gentian Medja.

Përbërja e Kolegjit

Sokol Sadushi
Asim Vokshi⁷
Arbena Ahmeti
Gentian Medja
Sokol Ngresi
Enkelejda Metaliaj

Përbërja e Kolegjit

Artur Kalaja
Ervin Pupe
Margarita Buhali
Enton Dhimitri
Vojsava Kola
Valbon Çekrezi

Kolegji Civil

Trupat e përhershme		
<i>Trupi Gjykses 1</i>	<i>Trupi Gjykses 2⁸</i>	<i>Trupi Gjykses 3</i>
Artur Kalaja Ervin Pupe Enton Dhimitri	Margarita Buhali Vojsava Kola Valbon Çekrezi	Artur Kalaja Ervin Pupe

Kolegji Penal

Trupë e përhershme	
<i>Trupi Gjykses 1</i>	<i>Trupi Gjykses 2⁹</i>
Ilir Panda Sokol Binaj Sandër Simoni	Ilir Panda Albana Boksi Medi Bici

7. Gjyqtar A. Vokshi ka ushtruar detyrën si gjyqtar efektiv deri më 26.11.2025.
8. Sipas vendimit nr. 15, datë 10.10.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024, “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykesë të secilit kolegj”, nisur nga mungesa e gjyqtarës V. Kola, si rezultat i marrjes së lejes së lindjes dhe i një vendi vakant që është krijuar në Kolegjin Civil, procedurë e cila ende nuk është mbyllur nga KLGJ për emërimin e gjyqtarit tjetër, Këshilli i Gjykatës vendosi që Trupi gjykses nr. 2 do të përbëhet nga Valbon Çekrezi, Margarita Buhali, Artur Kalaja/Ervin Pupe/Enton Dhimitri. Duke filluar nga muaji Nëntor 2025, rendi i shqyrtimit të çështjeve civile të Trupit Gjykses nr. 2 përcaktohet në mënyrë

- periodike, mbi bazë javore, sipas skemës si më poshtë:
- a) për çështjet e planifikuara në javën e parë, në përbërje të trupit gjykses do të jetë gjyqtari Artur Kalaja;
 - b) për çështjet e planifikuara në javën e dytë, në përbërje të trupit gjykses do të jetë gjyqtari Ervin Pupe;
 - c) për çështjet e planifikuara në javën e tretë, në përbërje të trupit gjykses do të jetë gjyqtari Enton Dhimitri.
- Mbas javës së tretë të muajit Nëntor 2025, rendi i shqyrtimit të çështjeve vijon të përsëritet në mënyrë ciklike, duke ndjekur skemën e përcaktuar më lart

Përbërja e Kolegjit

Ilir Panda
Sandër Simoni
Albana Boksi
Medi Bici
Sokol Binaj
Genti Shala ¹⁰

Njësia e Shërbimit Ligjor

Në vendimin nr.1, datë 21.01.2021, të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, është përcaktuar se organika e Njesisë së Shërbimit Ligjor përbëhet nga 32 këshilltarë ligjorë. Me vendimin nr.1, datë 12.09.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rritjen e numrit të Njesisë së Shërbimit Ligjor në 38. Në vitin 2025, pranë Gjykatës së Lartë u komanduan 5¹¹ këshilltarë të rinj (ndihmësmagjistratë), ndërkohë përfundoi periudhën e komandimit 1 këshilltarë ligjorë ndihmësmagjistratë.¹² Vakancat në organikën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, ashtu si edhe ato në trupën gjyqesore, ndikojnë drejtpërdrejt

9. Me emërimin e gjyqtarit Genti Shala, trupat gjyqësorë për të gjitha çështjet e shortuara për gjyqtarin Medi Bici do të zëvendësohen nga gjyqtari i ri.

10. Me Dekretin nr. 471, datë 12.12.2025, Presidenti i Republikës emëroi z. Genti Shala, si gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

11. Valiona Haxhiraj, Renis Sheshi, Erola Tarelli, Dorinela Nikolli, Iva Bregasi.

12. Iva Zemani

14. Saimir Nazifi, i pezulluar në pritje të vendimit të KPA. Eva Hysko me leje lindje nga marsi 2025 e në vijim. Inesa Cela me leje lindje janar-korrik 2025.

në efikasitetin e veprimtarisë gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Organika e Njesisë së Shërbimit Ligjor deri në fund të vitit 2025 ka qenë si vijon:

Njësia e Shërbimit Ligjor – Situata faktike		
Ndihmësmagjistratë	Këshilltarë Ligjorë	% e Këshilltarëve efektivë përkundrejt organikës
11	188	80%
Efektivisht në detyrë ¹³		

Njësia e Shërbimit Ligjor - Referuar organikës së miratuar nevojiten edhe¹⁴

Ndihmësmagjistratë	Këshilltarë Ligjorë
8	0

Burimet Njerëzore

Qendra e Doku- mentacionit	Administrimi Gjyqësor	Burime mbështetëse
8	25	47

14. Deri në shtator 2024, numri i miratuar ka qenë 32 këshilltarë ligjorë.

Raporti staf mbështetës / gjyqtar --- nëpunës civilë gjyqësorë për çdo gjyqtar						
nr. i gjyqtarëve efektivë	nr. i gjyqtarëve në organikë	nr. i stafit mbështetës në organikë	nr. i stafit mbështetës në fakt	fakti / organika në %	staf për gjyqtar sipas organi-kës	staf për gjyqtar sipas faktit
16*	19	132	115	87%	7	6

* 16 gjyqtarë efektivë dhe një gjyqtar me kohë të plotë si anëtar i KLGJ

Masat organizative dhe administrative të ndërmarra nga Gjykata e Lartë përgjatë vitit 2025 kanë prodhuar efekte pozitive në veprimtarinë e Gjykatës së Lartë dhe kanë sjellë përmirësimin e efikasitetit të punës së strukturave të saj si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve gjyqësore që i ofrohen publikut.

Përgjatë vitit 2025 u arrit një *Normë e Likuidimit të Çështjeve* (NLÇ) apo raporti midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të regjistruara rishtazi, prej 274%.

Kjo normë tejkalon të gjitha rekomandimet/standardet minimale ndërkombëtare që janë në raportin 1:1 ose 100%

Standardi minimal ndërkombëtar i normës së likuidimit të çështjeve	Normë e Likuidimit të Çështjeve për 2025
100%	274%

VEPRIMTARIA GJYQËSORE

Pavarësisht se numri i vendimeve gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Lartë edhe në vitin 2025 ka vijuar të jetë i lartë, ai nuk ka qenë qëllim në vetvete. Gjykata e Lartë jep vendime të rëndësishme, të cilat për shkak të arsytimit dhe autoritetit të tyre, synojnë orientimin e gjykatave më të ulëta dhe praktikantëve të tjerë të së drejtës. Në përmbushje të misionit të saj, Gjykata ka dhënë edhe vendime të ndërmjetme që lidhen me procesin e njësimin të praktikës, me kuptimin dhe interpretimin e ligjit në çështje të ndryshme. Kjo praktikë do të vazhdojë të konsolidohet përmes jurisprudentës, duke ofruar më tepër siguri juridike për qytetarët dhe kontribuar në forcimin e shtetit të së drejtës.

Mbi bazën e planit të veprimit të miratuar nga Gjykata e Lartë për evadimin e stokut të çështjeve gjyqësore të prapambetura, kolegjet kanë vijuar me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore sipas sistemit dybinar të shqyrtimit të tyre, ku i pari bazohet në *parimin e shqyrtimit kronologjik* (referuar kohës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë), ndërsa i dyti bazohet në *parimin e përparësisë*, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore si dhe në aktet nënligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me gjykimin me procedurë të përshpejtuar të çështjeve gjyqësore. Parimi i shqyrtimit kronologjik zbatohet në mënyrë strikte, duke mos lejuar kapërcimin e radhës kronologjike të çështjeve, përveç çështjeve emergjente dhe ato për të cilat kërkohet përshpejtimi, si raste përjashtimore, ku detyrimisht nevoja për kapërcimin e radhës kronologjike për këto lloj gjykimesh arsyetohet në çdo rast me vendim nga gjyqtari relator. Përjashtimin

nga rendi kronologjik i shqyrtimit Gjykata e Lartë e ka bërë vetëm për zbatimin me analogji të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 “*Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit*” (i ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 09.05.2024) të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithashtu dhe vendimit nr. 9, datë 03.06.2024 “*Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të disa çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë*”. Në këtë grup bëjnë pjesë çështje, shqyrtimi i të cilave sipas procedurës normale do të kërkonte kohë, çfarë do të sillte një përkeqësim të situatës juridike apo pasoja të rënda në gëzimin e të drejtave të ligjshme për palët në proces. Çështje të tilla janë të lidhura me konfliktet e punës, sigurimet shoqërore, konfliktet familjare, me vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut që kanë gjetur shkelje në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, si dhe vendime të ndërmjetme (masa e sigurimit të padisë, pezullimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, masat e sigurimit penal) ekstradimet, etj.

Gjatë vitit 2025 janë marrë disa vendime të cilat trajtojnë aspekte juridike të rëndësishme për konsolidimin, njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Disa prej tyre janë:

Vendime administrative**Elementët thelbësorë të trajtuar**

**Vendimi njësues nr.
00-2025-1483(1), datë
13.01.2025 i KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka njësuar praktikën gjyqësore, duke theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë, si një e drejtë me karakter jo absolut mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i saj. Kufizimi i të drejtës për rekurs, që vjen për shkak të parashikimit ligjor ose të njësimi a zhvillimit të praktikës gjyqësore, është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës dhe me ligjin nr. 49/2012, kur vlerësohet se një masë e marrë është e nevojshme, e përshtatshme dhe ka një qëllim legjitim për interesin publik, shërben për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, si dhe vendos një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Referuar dispozitave të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të cilat lidhen me interesin publik që ka ngritja dhe bërja funksionale brenda afateve të arsyeshme e organeve kushtetuese, por edhe me sigurinë juridike dhe administrimin e mirë të drejtësisë, togfjalëshi “vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë” kufizon të drejtën e rekursit për palët në proces.

**Vendimi njësues nr.
00-2025-4083 (79) datë
18.02.2025 i KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka njësuar praktikën gjyqësore, duke përcaktuar se i) Në zbatim të nenit 68, pika 5 të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, më datë 07.05.2020, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë, përveç rasteve kur shkak ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1 të këtij ligji. ii) Kur mungon vullneti i shprehur për heqjen dorë nga e drejta e padisë prej ASHK, në zbatim të nenit 68, pika 4 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” gjykatat vijojnë shqyrtimin e padive të ngritura nga prefektët me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP, sipas kriterëve të këtij ligji. iii) Në rast se në padi ngrihen formalisht pretendime me shkaqe nga ato të përcaktuara nga neni 7, pika 1 të ligjit nr. 20/2020 gjykatat disponojnë për pranimin ose rrëzimin e padisë, varësisht gjendjes së faktit të vërtetuar. Nëse padia nuk ngre formalisht asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 7, pika 1 të ligjit nr. 20/2020, gjykatat vlerësojnë mungesën e legjitimitit aktiv material të palës paditëse dhe disponojnë me rrëzimin e padisë.

**Vendimi nr. 00-2025-1358
(84), datë 19.02.2025, i
KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se në çështjet që lidhen me vlerësimin financiar të pronave të njohura për kompensim, gjykatat duhet të garantojnë hetim të plotë dhe zbatim të saktë të ligjit material, duke përcaktuar me kujdes zërin kadastral të pronës në kohën e shpronësimit dhe metodologjinë përkatëse të vlerësimit financiar, në përputhje me ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore të zbatimit. Saktësia në përcaktimin e zërit kadastral përbën kusht thelbësor për sigurimin e kompensimit të drejtë financiar dhe për respektimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor.

**Vendimi nr.00-2024-
5478(561), datë 17.12.2024
i KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se kur një jorezident ofron shërbime që lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin, projektimin ose administrimin e një pasurie të paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, këto shërbime konsiderohen të kryera në territorin shqiptar. Për këtë arsye, TVSH paguhet në Shqipëri, pavarësisht se cilën skemë tatimore aplikon subjekti. Nëse subjekti zgjedh të përdorë skemën e autofaturimit për shërbimet e marra nga një jorezident, por nuk paguan TVSH, atëherë lind detyrimi për ta paguar atë. Kjo sepse skema e autofaturimit dhe ajo e përfaqësuesit tatimor prodhojnë të njëjtin efekt tatimor vetëm kur TVSH është realisht e paguar në organet tatimore.

**Vendimi nr.00-2024-
5464(532), datë 11.12.2024
i KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se shoqatat dhe grupet e interesit kanë legjitimitet aktiv për të kundërshtuar aktin normativ nënligjor, për sa kohë përfaqësojnë interesa të ligjshme të një numri të pacaktuar dhe të papërcaktueshëm të individëve që mund të preken nga ky akt. Pretendimet për dëme ekonomike ose vetjake të anëtarëve të shoqatës gjatë zbatimit të aktit, nuk mjaftojnë për të justifikuar interesin e shoqatës për ta kundërshtuar atë. Kjo është e mundur vetëm nëse argumentohet qartë se po mbrohet një interes publik.

**Vendimi nr.00-2025-76(19),
datë 21.01.2025 i KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se përvoja e magjistratit të komanduar në institucione jashtë sistemit të drejtësisë është përvojë pune në profesion (vjetërsi). Performanca e punës së magjistratit të komanduar vlerësohet në përputhje me sistemin e vlerësimit të strukturës ku është komanduar. Vlerësimi i rezultateve në punë të magjistratit në strukturën ku është komanduar njihet nga ligji nr. 96/2016 dhe duhet të konvertohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor brenda sistemit të drejtësisë. Kur magjistrati i komanduar jashtë sistemit të drejtësisë disponon një vlerësim profesional më të shkurtër kohor sesa koha e përcaktuar në nenin 84 të ligjit nr. 96/2016, ky vlerësim është i konvertueshëm në nivelin përkatës për periudhën faktike kohore të komandimit, por nuk i siguron atij një vlerësim tre vjeçar të menjëhershëm.

**Vendimi nr. 00-2025-2559
(91), datë 27.02.2025 i
KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se kur kemi vendime kompensimi të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara, referuar nenit 6 (7) të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, llogaritja e vlerës financiare kryhet mbi dy elemente: (i) indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe (ii) interesin bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë. Periudha e llogaritjes është nga njohja e të drejtës për kompensim deri në datën e publikimit nga ATP, pra ligji nuk njeh aplikimin e këtyre elementeve përtej kësaj date.

**Vendimi nr. 00-2025-2391
(266), datë 19.06.2025 i
KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se në rastin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për gjokat administrative, gjykata e faktit ka detyrimin të përlllogarisë edhe kamatëvonesat sipas nenit 30 të ligjit nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative", pasi kjo dispozitë nuk parashikon përjashtime, duke qenë e qartë, e zbatueshme dhe në përputhje me qëllimin e ligjit. Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv, në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ, ndërsa barra e provës për njoftimin e debitorit, si dhe mënyrën e llogaritjes së kamatës, i takon palës kërkuese.

**Vendimi nr 00-2025-3176
(342), datë 18.09.2025 i
KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka përcaktuar se afati 30-ditor për paraqitjen e padisë ndaj vlerësimit financiar të ATP fillon 10 ditë pas publikimit të aktit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare. Kur akti administrativ nuk tregon qartë të drejtën dhe afatin e ankimit, njoftimi konsiderohet i metë dhe afati për ushtrimin e padisë është njëvjeçar, sipas nenit 18/2 të ligjit nr. 49/2012, duke u interpretuar në favor të palës për garantimin e aksesit në gjykatë.

**Vendimi njësuës nr.00-2024-
5431(435), datë 23.10.2024 i
KAGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Administrativ ka njësnuar praktikën gjyqësore, duke përcaktuar se statusi i punonjësve të Policisë së Shtetit, i miratuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.108/2014, u njeh punonjësve të Policisë së Shtetit të drejtën për të kërkuar në rrugë gjyqësore riktëhimin në detyrë, në rastet kur konstatohet paligjshmëria/pavlefshmëria e aktit të përjashtimit apo të lirimit nga Policia e Shtetit.

Vendime civile

Elementët thelbësorë të trajtuar

Vendimi njëses nr. 00-2024-5438(191), datë 18.04.2024 i KCGJL



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka përcaktuar se fatura e energjisë elektrike për pjesën e dëmit ekonomik të faturuar nga shoqëria e shpërndarjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin nr.10362, datë 16.12.2010, dhe ajo e lëshuar sipas Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe akteve nënligjore të ERE, të dala në zbatim të secilit ligj në këtë fushë, ka cilësinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi nr. 00-2024-4573(643), datë 14.11.2024 i KCGJL



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka shqyrtuar kërkesën për dëmshpërblim nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve për aksident detar fatal me mjet motorik lundrues . KCGJL konkludon se mungesa e legjislacionit të posaçëm për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike lundruese nuk e zhvendos automatikisht barrën e kompensimit mbi BSHS.

Vendimi nr. 00-2025-792(123), datë 26.02.2025 i KCGJL



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka përcaktuar se kur subjekti kërkes ngre pretendime lidhur me vlefshmërinë e vendimin e KKKP si akt “quasi gjyqësor” dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të saj, gjykata duhet të zhvillojë një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë të gjithë ndërgjyqësve, dhe jo të rrëzojë padinë me argumentin se mjeti i duhur është ai i kundërshtimit të vendimit të KKKP.

Vendimi nr. 00-2025-779 (114), datë 26.02.2025 i KCGJL



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka shqyrtuar pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së përbashkët pas zgjidhjes së martesës. KCGJL thekson se disponimet e vlefshme të pasurive të përbashkëta të kryera gjatë martesës me pëlqimin e ndërsjellë të bashkëshortëve (si shitja e truallit me kontratë të nënshkruar nga të dy dhe me përcaktim të qartë se kush përfiton çdo këst) përjashtohen nga pjesëtimi gjyqësor pas divorcit, pasi përbëjnë veprim disponues të pjesës ideale të një bashkëshorti në favor të tjetrit.

**Vendimi nr. 00-2025-765(80),
datë 12.02.2025 i KCGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka trajtuar afatin e parashkrimit për kërkimin e dëmshpërblimit nga punëdhënësi ndaj punëmarrësit për përfitim page në mënyrë të parregullt. KCGJL arsyetoi se afati 3-vjeçar i parashkrimit fillon ipso jure nga dita kur ka ndodhur dëmi, pavarësisht se kur ka marrë dëni punëdhënësi, prandaj pas skadimit të këtij afati punëdhënësi humbet të drejtën për ta kërkuar dëmshpërblimin në rrugë gjyqësore.

**Vendimi nr. 00-2025-657(94),
datë 12.02.2025 i KCGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka përcaktuar nëse kërkesat dhe pretendimet e pamarra parasysh në vendimin e shkallës së parë, nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre. Ato nuk mundet asesi të konstatohen kryesisht nga gjykata, pasi kanë rënë në dekadencë dhe sipas parimit që disiplinon procesin e rregullt ligjor nuk mund të rishqyrtohet më shumë se sa është apeluar.

**Vendimi nr. 00-2025-404(69),
datë 05.02.2025 i KCGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka trajtuar vlefshmërinë e testamentit që disponon në mënyrë jo proporcionale ndërmjet trashëgimtarëve. KCGJL arsyetoi se lënia e sendeve me vlerë thyeshit simbolike me qëllim për të shmangur rezervën ligjore të trashëgimtarëve të mitur ose të paastë për punë mund të konsiderohet si përjashtim i heshtur nga trashëgimia dhe cenim i rezervës ligjore sipas nenit 379 të Kodit Civil.

**Vendimi nr. 00-2025-
1400(178), datë 09.04.2025 i
KCGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka përcaktuar se e drejta për dëmshpërblim për shkelje të së drejtës së autorit është e drejtë subjektive personale e autorit dhe mund të ushtrohet pavarësisht nga të drejtat e botuesit; mosthërrja e botuesit të veprës letrare nuk prek automatikisht të drejtën e tij.

**Vendimi nr. 00-2025-1381, datë
09.04.2025 i KCGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka përcaktuar se sipas Konventës së Montrealit, familjarët që vuajnë dëme pasurore ose jopasurore për shkak të dëmtimit ose vdekjes së një të afërmi, nuk mund të paraqesin padi në vendqëndrimin e çakonsbëm të tyre nëse dëmi i drejtpërdrejtë nuk ka ndodhur atje.

**Vendimi nr. 00-2025-
2270(294), datë 04.06.2025 i
KCGJ**



Në këtë çështje, Kolegji Civil ka trajtuar efektin prapaveprues të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 27/2010 që shfuqizoi kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP për të shfuqizuar vendimet e zyrave vendore. KCGJL konkludon se vendimi kushtetues ka efekt prapaveprues vetëm për çështjet që ishin në shqyrtim gjyqësor në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit kushtetues (05.07.2010) ose pasojat e paezauruara të ligjit të shfuqizuar.

Vendime penale

**Vendimi njëses
nr.00-2024-2155(107), datë
24.04.2024 i KPGJL**



Elementët thelbësorë të trajtuar

Në këtë çështje, Kolegji Penal ka njësnuar praktikën gjyqësore duke përcaktuar se neni 334, ndonëse është një dispozitë e Kodit Penal, në raport me nenin 28, paragrafët 5 e 6 të këtij Kodi nuk është një vepër penale më vete, por një dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga organizatori apo pjesëmarrësi në një organizatë kriminale ose në një grup të strukturuar kriminal. Veprat penale të parashikuara në nenet 333 dhe 333/a të Kodit Penal janë vepra penale formale, që nënkupton se personi dënohet për kryerjen e këtyre veprave (në formën e krijimit, organizimit, drejtimit apo pjesëmarrjes), pavarësisht nëse kryen apo jo ndonjë vepër penale konkrete. Zbatimi i nenit 334 të Kodit Penal në raport me nenet 333 dhe 333/a të këtij Kodi, nuk cenon parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtin fakt penal (sipas nenit 7 të KPP), pasi neni 334 është një dënim i shtuar vetëm kur pjesëtarët e organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal kryejnë një vepër penale konkrete. Veprat penale “Organizatë kriminale”/ “Grupi i strukturuar kriminal” kryhen në formën e krijimit, organizimit, drejtimit apo pjesëmarrjes dhe cilësohen nga Kodi Penal si vepra penale më vete. Kodi Penal ndëshkon jo vetëm kryerjen e veprave penale konkrete në kuadër të një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal, por edhe vetë krijimin, organizimin, drejtimin apo pjesëmarrjen në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, parashikuar si vepra penale më vete, sipas neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal. Neni 334 i Kodit Penal nuk është një dispozitë që zbatohet veçmas (nuk është vepër penale), por është dënim i shtuar që shoqëron dispozitën penale e cila parashikon figurën e veprës penale konkrete të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal.

**Vendim njëses nr.00-2024-2161(167), datë 04.07.2024
i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka njësnar praktikën gjyqësore duke përcaktuar se ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2, i Kodit të Procedurës Penale, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetsbëm. Kur akuzë është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetsbëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar. Nëse gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonsbëm, i ja të parë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetsbëm. b. Të çmohet që çështja mund të zgjidhet në gendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale.

**Vendimi njëses nr.00-2025-2162(275), datë
06.11.2024 i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka njësnar praktikën gjyqësore duke përcaktuar se parashikimi i nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohe vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë. Vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga kërkimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, por kur gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues. Gjatë gjykimit në shkallë të dytë, në përputhje me nenin 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat deklarative që janë të nevojshme në drejtim të përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit. Nëse çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, parashikimi i nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor edhe përmes marrjes së provave të reja. Të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit, në rastin e dhënies së vendimit të fajësisë nga ana e gjykatës së apelit.

**Vendimi njësues
nr. 00-2025-1007 (82), datë
27.03.2025 i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka njësuar praktikën gjyqësore duke vendosur se pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë, është e detyrueshme. Mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit dhe kërkesën për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit.

**Vendimi njësues nr. 00-
2025-1733 (87), datë
03.04.2025 i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka njësuar praktikën gjyqësore duke vendosur se gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masa disiplinore e të tjera) i takon juridiksionit penal. Shqyrtimi i tyre do të bëhet nga gjykatat penale sipas legjislacionit procedural penal lidhur me ekzekutimin e vendimit penal. Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk legjitimohen për të paraqitur ankim kundër vendimarrjes së gjykatave penale që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Ky rregull nuk gjen zbatim vetëm në rastet kur objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatat penale është akti administrativ (vendimi i administratës së burgjeve), sipas parashikimeve të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në këto raste Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve thirren si palë dhe legjitimohen të paraqesin ankim. Zhvillimi i seancës pa pjesëmarrjen e prokurorit ose/ dhe mbrojtësit të të interesuarit, sikundër përcakton neni 471, pika 4 i KPP, sjell pavlefshmërinë absolute të aktit (vendimit).

**Vendimi nr. 00-2025-785
(116), datë 13.05.2025 i
KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se forma e bashkëpunimit nuk mund të kualifikohet ndryshe për të bashkëpandehurit kur Gjykata e Lartë ka përcaktuar më parë natyrën juridike të bashkëpunimit për disa prej tyre të gjykuar veçmas, dhe gjykatat e faktit dështojnë të analizojnë mosaplikimin në rastin konkret.

**Vendimi nr. 00-2025-797,
datë 13.05.2025 i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se kur vendimi i dënimit me burgim, i pezulluar konform nenit 59 të KP, ndonëse në aspektin formal-kohor rezultojnë i ekzekutuar, procesi i verifikimit të ekzekutueshmërisë së këtij dënimi në aspektin material, kërkon shqyrtim dhe debat gjyqësor ndërmjet palëve në proces.

**Vendimi nr. 00-2025-824
(123), datë 22.05.2025
i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se mosnjohimi i prokurorit apo palëve në shqyrtimin e kërkesës për rishtikim të vendimit penal të formës së prerë nuk përbën shkak pavlefshmërie, pasi kjo fazë procedurale zhvillohet në dhomë këshillimi dhe nuk përfshin gjykim mbi themelin e çështjes.

**Vendimi nr. 00-2025-894
(138), datë 29.05.2025 i
KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se personi që tërbeq një interes konkret dhe aktual në çështjen ku përveç pushimit të çështjes, deklarohet edhe falsiteti dhe asgjësimi i dokumenteve të falsifikuara (me pasoja civile në një proces tjetër), dubet të njoftohet dhe t'i garantohet e drejta për tu dëgjuar, në garantim të procesit të rregullt ligjor.

**Vendimi nr. 00-2025-883,
datë 29.05.2025 i KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se një kërkesë që në përmbajtje apo natyrë i përket fazës së hetimeve paraprake, siç mund të jetë edhe zëvendësimi i masës së sigurimit personal, do të shqyrtohet nga gjyqtari i hetimeve paraprake vetëm nëse penal në atë shkallë gjykimi ndodhet ende në këtë fazë. Nëse një kërkesë e tillë paraqitet ndërkohë që çështja në atë shkallë gjykimi ka kaluar në një fazë tjetër, siç është seanca paraprake apo gjykimi në themel, atëherë ajo do të shqyrtohet nga gjykata kompetente e asaj faze ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës.

**Vendimi nr. 00-2025-1402
(221), datë 23.09.2025 i
KPGJL**



Në këtë çështje, Kolegji Penal ka përcaktuar se ndalimi i gjykit të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm është absolut dhe lidhet vetëm me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale, jo me subjektin apo veçoritë personale të autorit. Ky ndalim nuk cenohet nga dispozitat që përjashtojnë gratë nga burgimi i përjetshëm.


VEPRIMTARIA E GJYKATËS SË LARTË NË STATISTIKA

Numri i madh i çështjeve të grumbulluara në vite në Gjykatën e Lartë mbetet ende një problem shqetësues dhe një sfidë për veprimtarinë e saj me ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e procesit të administrimit të shpejtë dhe efektiv të drejtësisë. Me gjithë vështirësitë e hasura në kuadër të plotësimit të stafit me këshilltarë ligjorë ndihmësmagjistratë ose jo, si dhe staf administrativ, treguesit e vlerësimit sasior të veprimtarisë gjyqësore të Gjykatës së Lartë tregojnë ndryshime të dukshme të prirjes në krahasim me periudhën para vitit 2020. Këta tregues sasiorë (2020-2025) pasqyrojnë rezultate premtuese për të ardhmen që konfirmojnë punën e madhe të kryer nga kolegjet e Gjykatës, në drejtim të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura.

Çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë

Për sa i përket numrit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Lartë, tashmë prej disa vitesh, vihet re një prirje në ulje, e cila vjen si pasojë e ndryshimeve në kompetencat e Gjykatës, sipas legjislacionit të ri procedural, si dhe të uljes së numrit të çështjeve të përfunduara në gjykatat e apelit. Edhe pse në vitin 2025 janë regjistruar 2% më shumë çështje se në vitin 2024, numri i çështjeve të reja të regjistruara mbetet me prirje në ulje krahasuar me çështjet e reja të regjistruara në vitet 2019-2022. Tre vitet e fundit 2023-2025 tregojnë një prirje konstante në prurjen e çështjeve të reja drejtuar Gjykatës së Lartë, me një rritje të lehtë gjatë vitit të fundit. Përkatësisht përgjatë vitit 2023 janë regjistruar 2145 çështje të reja, në vitin 2024 janë regjistruar 2469 çështje të reja dhe në vitin 2025 janë regjistruar

2513 çështje të reja duke shënuar 1.8 % rritje në krahasim me një vit më parë.






Gjatë vitit 2025, vihet re një prirje në rritje e numrit të çështjeve administrative të regjistruara në gjykatë prej 14% më shumë krahasuar me vitin 2024. Edhe pse krahasimisht në ulje me prurjet e viteve 2019, përkatësisht me 58%, tashmë vihet re një prirje e konsoliduar në rritje në numrin e çështjeve të reja administrative të regjistruara në Gjykatën e Lartë. Krahasuar me vitin 2022, si viti me numrin më të ulët të çështjeve të reja administrative të regjistruara, kjo rritje llogaritet me 164% duke iu afruar shifrës së vitit 2020. Një rritje e tillë mund t'i atribuohet

funkcionimit tashmë të Gjykatës Administrative të Apelit me trupë të plotë gjyqësore prej 13 gjyqtarësh dhe rritjes së volumit të vendimmarrjes atje.

Çështjet civile të regjistruara në vitin 2025, shënojnë një ulje të lehtë me 9% në krahasim me vitin e kaluar 2024. Nëse krahasohen me vitin 2023 numri i çështjeve të reja të regjistruara në vitin 2025 është pothuajse i njëjtë dhe 6% më pak se në vitin 2022. Krahasuar me vitin 2019 dhe 2020, kjo përqindje është përkatësisht 72% dhe 41% më pak. Pra, mund të thuhet se gjatë 4 viteve të fundit (2022-2025) prirja e numrit të çështjeve të reja civile të regjistruara është pak a shumë e njëjtë, por krahasimisht në ulje të lartë me vitet 2019-2020.

Ndërsa çështjet penale qëndrojnë pak a shumë konstante në prirje kryesisht në rënie, me një prurje pothuajse të njëjtë në krahasim me vitin 2024 dhe një ulje prej 8% në krahasim me vitin 2023. Në krahasim me vitin 2019, ulja llogaritet me 30%.

Çështjet administrative të regjistruara në vitin 2025 zënë një volum prej 40% të ngarkesës së gjykatës, çështjet civile zënë një volum prej 29% ndërsa ato penale zënë një volum prej 31%.



Siç vihet re nga prirja në tre vite 2019, 2020 dhe 2021, çështjet civile kryesisht zënë vendin më të madh mes çështjeve të paraqitura pranë Gjykatës së Lartë. Në periudhën 2022-2023, volumin më të madh e zënë çështjet penale, ndërsa për periudhën 2024-2025 vihet re një prirje në rritje për sasinë e çështjeve administrative, ndërkohë që çështjet civile kanë një prirje të lehtë në rënie.

Çështjet e gjykuara në Gjykatën e Lartë

Për sa i përket numrit të çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Lartë, vihet re një prirje e dukshme në rritje ndër vite. Në krahasim me vitin 2019, numri i çështjeve të gjykuara është rritur 14 herë. Edhe pse në vitin 2025 janë gjykuar 10% më pak çështje se në vitin 2024 dhe 13% më pak se në vitin 2023, ky numër është në rritje me 9 % më shumë krahasuar me vitin 2022, 91% më shumë krahasuar me vitin 2021 dhe përkatësisht me 365% krahasuar me vitin 2020. Ulja në gjykim nga viti 2024 është pasojë e pritshme e uljes së kapacitetit gjykues të Gjykatës së Lartë përgjatë dy viteve të fundit.


E njëjta prirje vihet re edhe në ndarjen e çështjeve sipas natyrës. Kështu, në krahasim me vitin 2019, çështjet administrative të gjykuara janë rritur 11 herë, çështjet civile 25 herë dhe çështjet penale 11 herë.

Çështjet administrative të gjykuara në vitin 2025 kanë pasuar një rënie të lehtë prej 3% krahasuar me vitin 2024 dhe një rënie prej 16% krahasuar me vitin 2023, edhe pse në rritje prej 8% krahasuar me vitin 2022, 112% krahasuar me vitin 2021 dhe 321% krahasuar me vitin 2020.


Çështjet civile të gjykuara në vitin 2025 kanë pësuar një ulje prej 17% krahasuar me vitin 2024 dhe 11% krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë ato janë në rritje me 8% krahasuar me vitin 2022, 79% krahasuar me vitin 2021 dhe 494% krahasuar me vitin 2020.

Çështjet penale të gjykuara në vitin 2025 kanë pasuar një rënie me 9% krahasuar me vitin 2024 dhe 12% krahasuar me vitin 2023, edhe pse në rritje prej 9% krahasuar me vitin 2022, 81% krahasuar me vitin 2021 dhe 312% krahasuar me vitin 2020.


Shifrat e mësipërme tregojnë se pavarësisht ndryshimeve në trupat gjykues apo kapacitetet e gjykimit, Gjykata e Lartë ka arritur të mbajë një ritëm të qëndrueshëm në gjykimin e çështjeve. Megjithatë, situata e çështjeve që priten për gjykim në vitet e fundit paraqitet shumë ndryshe nga ato të fillim viteve 2020-2021, ku fokusi i gjykimit ishte evadimi i backlogut kryesisht nga çështjet e papranueshme. Në vitin 2025 tërësia e çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Lartë paraqitet kryesisht në çështje themeli, të cilat kërkojnë vëmendje dhe kohë të shtuar në trajtimin e problematikave juridike që bartin, nisur nga koha e regjistrimit të tyre. Në këto kushte është më rëndësi të theksohet se përtej presionit numerik i cili vazhdon të jetë aktual, sfida e momentit për Gjykatën e Lartë është trajtimi me rëndësinë dhe kujdesin e duhur të çështjeve të themelit të cilat janë baza e evidentimit të çështjeve të mundshme për njësim ose zhvillim.



Çështjet administrative të gjykuara në vitin 2025 zënë një hapësirë prej 36% të ngarkesës së Gjykatës, çështjet civile zënë 35%, ndërsa ato të natyrës penale zënë 29%.




Duke parë vendin që zënë çështjet e gjykuara sipas natyrës, vihet re që në përgjithësi, sasia qëndron mesatarisht e njëjtë për çështjet penale, administrative e civile të gjykuara në katër vitet e fundit.




Çështjet e gjykuara në raport me çështjet e regjistruara

Praktikat më të mira ndërkombëtare kërkojnë që analiza e performancës së gjykatës të përmbajë edhe një vështrim krahasimor mes çështjeve të gjykuara përkundrejt çështjeve të regjistruara në gjykatë. Edhe në këtë pasqyrë të përgjithshme vihet re prirja në ulje e çështjeve të reja të regjistruara dhe prirja në rritje e vendimmarrjes së gjykatës. Ndryshimi është i dukshëm duke krahasuar dy skajet e grafikut, ku paraqitet raporti i çështjeve të regjistruara dhe të gjykuara në vitin 2019 dhe vitin 2025.

Prirja në çështjet e regjistruara kundrejt atyre të gjykuara sipas Kolegjeve




Prirja në çështjet e regjistruara kundrejt atyre të gjykuara sipas viteve



Norma e Likuidimit të Çështjeve


Një nga treguesit kryesorë të efikasitetit të gjykatës, sipas standardeve dhe praktikave më të mira të CEPEJ është Norma e Likuidimit të Çështjeve që përcaktohet nga raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja, dhënë në përqindje. Ky tregues ofron një element krahasimor nëse gjykata ka arritur të ruajë ritmin mes çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara. Ky është gjithashtu tregues i prirjes për ndryshim të stokut.

Norma e Likuidimit të Çështjeve




Edhe në vitin 2025 Gjykata e Lartë ka arritur të tejkalojë standardin e pranuar ndërkombëtar 100%, duke arritur një Normë të Likuidimit të Çështjeve prej 274%, pra Gjykata ka gjykuar një numër shumë më të lartë çështjesh se numri i çështjeve të paraqitura pranë saj në vitin 2025. Kjo normë e shqyrtimit të çështjeve tregon prirjen e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura.

Në treguesin e Normës së Likuidimit të Çështjeve sipas natyrës, vërehet se treguesi për çështjet civile është në vlerën 326%, për çështjet penale 253%, ndërsa në çështjet administrative arrin në masën 251%. Të dhënat tregojnë se të tre kolegjet qëndrojnë jo vetëm përtej standardit ndërkombëtar në raportin 1 çështje e regjistruar me 1 çështje të gjykuar, por edhe për një ritëm mjaft të lartë të uljes së çështjeve të prapambetura.





Norma e Likuidimit sipas natyrës së çështjeve 2019 - 2025



Numri i çështjeve të gjykuara sipas natyrës së çështjes, vendimmarrjes dhe statusit


Në tabelën dhe grafikun më poshtë jepet një pasqyrë e vendimmarrjes së kolegjeve të ndara në kategori.

KOLEGJET	Nr. i vendimeve të themelit	Nr. i vendimeve për rishikim vendimi / masa sigurimi / rivendosje në afat... etj.	Nr. i vendimeve për kompetencë/ juridiksion	Nr. i vendimeve për pezullim ekzekutim vendimi / konstatim shkelje afati / përjashtim gjyqtari ...etj.	Totali për secilin Kolegj
Kolegji Civil	2107	90	99	99	2398
Kolegji Administrativ	2297	56	41	112	2506
Kolegji Penal	903	980	60	32	1975
TOTALI					6876



Numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga Gjykata në prani të palëve për vitin 2025, është 95, çfarë përbën 1.5% të vendimarrjes, ndërkohë që në tërësi vendimarrja dominohet nga dhoma e këshillimit. Për Kolegjin Administrativ gjykimi në dhomë përbën 97% të vendimarrjes, për Kolegjin Civil dhe Penal gjykimi në dhomë përbën 99% të vendimarrjes të ndara sipas natyrës së çështjeve në grafikën më poshtë:


Pranueshmëria e rekursit dhe llojet kryesore të vendimarrjes




Vendimet e mospranimit në dhomë këshillimi përbëjnë 72% të vendimmarrjes së përgjithshme të Gjykatës, ndërsa të ndara sipas natyrës së çështjeve ato zënë 71% në çështjet administrative, 64% në çështjet civile dhe 81% në çështjet penale.

Përqindja tjetër më e lartë e llojit të vendimmarrjes vërehet te prishja e vendimit/vendimeve të gjykatës së apelit/shkallës së parë dhe kthimi i çështjes për rigjykim me 15 % të rasteve, në vetëm 2% të vendimmarrjes Gjykata ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe vetëm në 3 % të rasteve gjykata ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Përqindja e pranueshmërisë dhe llojeve të tjera të vendimmarrjes - Administrative



Përqindja e pranueshmërisë dhe llojeve të tjera të vendimmarrjes - Civile




Përqindja e pranueshmërisë dhe llojeve të tjera të vendimmarrjes -Penale



Kolegji seleksionues

Kolegji Administrativ ka vijuar me shqyrtimin paraprak të rekurseve të paraqitura gjatë vitit 2025, me qëllim seleksionimin e tyre. 35% e rekurseve të regjistruara nuk u pranuan, si haptazi të pabazuara. 52% e çështjeve të shqyrtuara nga kolegji seleksionues do të vijnë në shqyrtimin në dhomë këshillimi sipas rendit kronologjik.




Suksesi i aplikimit të rekursit në mosmarrëveshjet midis shtetit dhe individit

Gjatë vitit 2025, Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e rekurseve të paraqitura që rezultojnë të pasuksesshme të ndara mes individit dhe shtetit në çështjet administrative dhe civile, si dhe midis prokurorit

e individit në çështjet penale pra, në sa raste organet publike dhe individët rezultojnë respektivisht si gjyqumbës.


Në çështjet penale, aplikimi i rekursit ka rezultuar i pasuksesshëm në 80% të rasteve kur rekursi është paraqitur nga individit dhe vetëm në 18% të rasteve kur ky mjet është paraqitur nga prokurori. Në çështjet administrative, rekursi ka rezultuar i pasuksesshëm në 55% të rasteve kur ky mjet është paraqitur nga shteti dhe në 42% kur është paraqitur nga individit.

Në çështjet civile, në 45% të rasteve rekursi ka rezultuar i pasuksesshëm nga individit dhe në 39% nga shteti. Mosmarrëveshjet ndërmjet individëve në çështjet civile apo ato kur rekursues është dhe shteti dhe individit nuk paraqiten në grafikën më poshtë.



Të dhëna statistikore janë hartuar edhe për numrin e rekurseve të paraqitura që rezultojnë të suksesshme të ndara mes individit dhe shtetit në çështjet administrative

dhe civile, si dhe midis prokurorit e individit në çështjet penale pra, në sa raste organet publike dhe individët rezultojnë respektivisht si gjyqfitues. Çështje civile që përbëjnë mosmarrëveshje ndërmjet individëve, çështje administrative që kanë rekursues si shtetin dhe individin si dhe çështjet penale që kanë rekursues si prokurorinë dhe individin nuk paraqiten në grafikën më poshtë.




Në çështjet penale, aplikimi i rekursit ka rezultuar i suksesshëm në 59% të rasteve kur rekursi është paraqitur nga individ dhe në 39% të rasteve kur ky mjet është paraqitur nga prokurori.

Në çështjet administrative, rekursi ka rezultuar i suksesshëm në 50% të rasteve kur ky mjet është paraqitur nga individ dhe në 46% kur është paraqitur nga shteti.

Në çështjet civile, në 45% të rasteve rekursi ka rezultuar i suksesshëm kur është paraqitur nga individ dhe në vetëm në 26% kur është paraqitur nga shteti.

Vendimet e ndërmjetme për njësimin e praktikës

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin vendimeve të ndërmjetme për njësimin e praktikës gjyqësore të dhëna nga kolegjet e saj për periudhën 2023-2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe përqindja e nivelit të arsytimit të vendimeve të tilla. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 janë dhënë 3 vendime të ndërmjetme për njësimin e praktikës gjyqësore nga të cilat 2 në çështje penale dhe 1 në çështje civile. Gjatë vitit 2024, gjykata ka dhënë në total 7 vendime të ndërmjetme për njësimin e praktikës gjyqësore nga të cilat 3 në çështje penale, 3 në çështje administrative dhe 1 në çështje të natyrës civile. Gjatë vitit 2023, gjykata ka dhënë gjithsej 13 vendime të ndërmjetme të njësimit të praktikës gjyqësore nga të cilat 4 në çështje të natyrës penale, 7 në çështje administrative dhe 2 në çështje civile.



Në periudhën kohore 2023-2025, prej 23 vendimeve të ndërmjetme për njësimin e praktikës gjyqësore, rezulton se janë zbardhur (arsyetuar) në total 87% e tyre ose 20 vendime njëseuse (3 civile, 10 administrative, 7 penale), ndërkohë që nuk janë arsyetuar ende 2 vendime njëseuse përkatësisht 1 vendim i marrë në vitin 2024 për çështje të natyrës penale dhe 1 vendimi i marrë në vitin 2025 në çështje të natyrës civile¹⁵. Në vitin 2025 Gjykata ka marrë 4 vendime njëseuse, 2 nga Kolegji Administrativ dhe 2 nga Kolegji Penal.





Çështjet e kthyer për rigjykim nga Gjykata Kushtetuese

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e vendimeve të kthyer për rigjykim nga Gjykata Kushtetuese sipas natyrës së çështjeve


15. Vendime të ndërmjetme për njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore dhe Vendime për njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore

për periudhën 2024-2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe niveli i shqyrtimit të tyre nga kolegjet përkatëse. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ka kthyer për rigjykim në Gjykatën e Lartë 21 çështje nga të cilat 7 të natyrës civile, 11 të natyrës administrative dhe 3 të natyrës penale. Ky numër është krahasimisht më i ulët se numri i çështjeve të kthyer për rigjykim nga Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2024 prej gjithsej 28 çështje (8 çështje civile, 12 administrative dhe 8 penale). Nga çështjet e kthyer gjatë vitit 2024, Gjykata e Lartë ka rigjykuar 71 % të tyre (ose 20 çështje) ndërkohë që përqindja e rigjykimit për çështjet e kthyer gjatë vitit 2025 është e ulët, afro 10%.



Çështje të kthyer nga Gjykata
Kushtetuese për rigjykim 2024

■ me vendimarrje ■ ende në shqyrtim


Çështje të kthyer nga Gjykata
Kushtetuese për rigjykim 2025

■ me vendimarrje ■ ende në shqyrtim

Kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit për çështje të Gjykatës së Lartë, sipas natyrës së çështjeve për periudhën 2024-2025. Gjithashtu, është parë me interes të veçohet edhe niveli i shqyrtimit të tyre nga kolegjet përkatëse si dhe përqindja e mospranimit.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 janë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë 65 kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, nga të cilat 37 kërkesa janë paraqitur pranë Kolegjit Civil, 24 pranë Kolegjit Administrativ dhe 4 pranë Kolegjit Penal. Ky numër është krahasimisht më i ulët se numri i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit gjatë vitit 2024 prej gjithsej 88 kërkesash përkatësisht 30 pranë Kolegjit Civil, 51 pranë Kolegjit Administrativ dhe 7 pranë Kolegjit Penal.

Kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të
arsyeshëm të gjykimit



Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar 100% të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të paraqitura gjatë vitit 2024, ndërsa për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2025 rezulton se për 78% e tyre është marrë vendim nga Gjykata e Lartë dhe 22% e tyre janë në pritje për shqyrtim.

Për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2024, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar 93% të tyre, ndërkohë që përqindja e kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2025 dhe që nuk janë pranuar nga kolegjet përkatëse është 72%.





Kërkesa për përshpejtim të gjykimit

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e kërkesave për përshpejtimin e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, për periudhën 2024-2025. Të dhënat tregojnë se, gjatë vitit 2025 janë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë 523 kërkesa për përshpejtim të gjykimit. Ky numër është krahasimisht më i ulët se numri i kërkesave për përshpejtim të gjykimit gjatë vitit 2024 prej gjithsej 657 kërkesash.



Gjykata e Lartë ka pranuar 45% e kërkesave për përshpejtim të gjykimit të paraqitura gjatë vitit 2024 dhe 36% të kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2025.




25% e kërkesave të paraqitura në vitin 2024 rezultojnë ende të pashqyrtuara nga kolegjet përkatëse, ndërkohë që përqindja e kërkesave të paraqitura gjatë vitit 2025 dhe që nuk janë trajtuar ende nga kolegjet përkatëse është 46%.

Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit


Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të paraqitura pranë Gjykatës së Lartë, për vitin 2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe niveli i shqyrtimit të tyre nga gjykata si dhe përqindja e mospranimit.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 janë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë 169 kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit (101 civile, 41 administrative dhe 27 penale).




73% e kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të paraqitura gjatë vitit 2025 nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë. Të ndara sipas natyrës rezulton se 71% e kërkesave civile, 63% e kërkesave administrative dhe 93% e kërkesave penale nuk janë pranuar nga Gjykata.

Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit




Përqindja e kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të pranuar nga Gjykata e Lartë për vitin 2025 është shumë e ulët, vetëm 9%, Të ndara sipas natyrës rezulton se vetëm 7% e kërkesave civile, 15% e kërkesave administrative dhe 7% e kërkesave penale janë pranuar nga Gjykata.


Kërkesa civile për pezullimin e ekzekutimit të vendimit



Kërkesa penale për pezullimin e ekzekutimit të vendimit




Kërkesa administrative për pezullimin e ekzekutimit të vendimit






Vendimarrja sipas çështjeve të themelit

Në grafikët e mëposhtëm, paraqitet vendimarrja për çështjet e themelit sipas 3 mujorëve, për vitin 2025 si dhe sipas kolegjeve.

Çështje themeli të gjykuara nga Gjykata e Lartë Janar - Dhjetor 2025




Mesatarisht janë gjykuar nga Gjykata e Lartë 482 çështje themeli në muaj. Në Kolegjin Administrativ janë gjykuar mesatarisht 209 çështje themeli në muaj, në Kolegjin Civil 192 dhe në Kolegjin Penal 82 çështje themeli në muaj.




Vendimarrja për masat e sigurimit në çështjet penale

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e masave të sigurimit të paraqitura pranë Kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, për periudhën 2022-2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe përqindja e mospranimit të tyre.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025, janë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë 171 kërkesa për masa sigurimi nga të cilat janë shqyrtuar 157 (92%). Nga të dhënat statistikore vihet re një prirje në ulje e numrit të masave të sigurimit të paraqitura pranë Kolegjit Penal. Ky numër është 19% më i ulët se numri i masave të paraqitura në vitin 2022 dhe 7% më i ulët krahasuar me vitin 2024.




Nga të dhënat statistikore vihet re një prirje e lartë e përqindjes së mospranimit të kërkesave të masave të sigurimit nga Kolegji Penal, rreth 65% e tyre. Kolegji Penal ka dhënë 45 vendime të tjera në të cilat 22 janë zgjidhje kompetence dhe vetëm 23 janë vendime të ndryshme nga mospranimi për të cilat 9 janë vendime në favor të avokatëve dhe 14 në favor të prokurorisë. Ndërkohë përqindja e mospranueshmërisë ka qenë përkatësisht 80% në vitin 2024, 76% në vitin 2023 dhe 75% në vitin 2022.



Vendimmarrja për masat e pezullimit në çështjet administrative

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e masave të pezullimit të paraqitura pranë Kolegjit Administrativ, për periudhën 2023-2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe përqindja e mospranimit të tyre.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025, janë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë 56 masa pezullimi nga të cilat janë shqyrtuar 50 (89%). Ky numër është 42% më i ulët se numri i masave të pezullimit të paraqitura pranë Kolegjit Administrativ në vitin 2024, por pothuajse i njëjtë me ato të paraqitura në vitin 2023.




Nga të dhënat statistikore të vitit 2025 vihet re një prirje e lartë e përqindjes së mospranimit të kërkesave të masave të pezullimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë prej 68% (68% në vitin 2024 dhe 59% në vitin 2023).



Vendimmarrja për masat e pezullimit në çështjet civile

Gjykata e Lartë ka hartuar të dhëna statistikore edhe për numrin e masave të pezullimit të paraqitura pranë Kolegjit Civil në Gjykatën e Lartë, për periudhën 2023-2025. Gjithashtu është parë me interes të veçohet edhe përqindja e mospranimit të tyre. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025, janë paraqitur pranë Kolegjit Civil 48 masa pezullimi nga të cilat janë shqyrtuar 47 (99%). Ky numër është 20% më i ulët se numri i masave të pezullimit të paraqitura pranë Kolegjit Civil në vitin 2024.

Nga të dhënat statistikore vihet re një prirje e lartë e përqindjes së mospranimit të kërkesave të masave të pezullimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë prej 77% në vitin 2025 (78% në vitin 2024 dhe 69 % në vitin 2023).



Volumi i punës për çdo gjyqtar

Tabela dhe grafiku më poshtë paraqet volumin e punës për çdo gjyqtar gjatë vitit 2025, sipas kolegjeve.

Kolegji Administrativ



Gjyqtarët	Nr. i vendimeve për vitin 2025
Arbena Ahmeti	450
Asim Vokshi	341
Enkelejda Metaliaj	458
Gentjan Medja	464
Sokol Ngresi	489
Sokol Sadushi	305

Kolegji Civil

Gjyqtarët	Nr. i vendimeve për vitin 2025
Artur Kalaja	354
Enton Dhimitri	410
Ervin Pupe	361
Margarita Buhali	599
Valbon Çekrezi	464
Vojsava Kola	211

Kolegji Penal

Gjyqtarët	Nr. i vendimeve për vitin 2025
Albana Boksi	392
Ilir Panda	401
Medi Bici	392
Sandër Simoni	405
Sokol Binaj	380



Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Gjyqtar

Treguesi NR, apo Norma e Rendimentit për Gjyqtar, është treguesi bazë i ritmeve mesatare të punës për gjyqtarin. Ky tregues për vitin 2025 paraqitet në vlerën 404 çështje të shqyrtuara për 17 gjyqtarë efektivë. Megjithatë duke llogaritur vetëm gjyqtarët me aktivitet të plotë, pa përfshirë situatat e veçanta shëndetësore, ngarkesa mesatare rezulton 429 çështje për gjyqtar. Duke marrë në konsideratë të dyja këto tregues, ngarkesa mesatare e ponderuar për vitin 2025 vlerësohet rreth 417 çështje për gjyqtar. Treguesi përlllogaritet si raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura dhe numrit të gjyqtarëve efektivë gjatë periudhës së raportimit. I përlllogaritur sipas kolegjeve përkatës treguesi NR paraqitet në vlerën 418 çështje të shqyrtuara për gjyqtar për kolegjin administrativ, 400 çështje të shqyrtuara për gjyqtar për kolegjin civil dhe 394 çështje të shqyrtuara për gjyqtar për kolegjin penal.

Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Njësinë e Shërbimit Ligjor


Tabelat dhe grafikët më poshtë paraqesin numrin e çështjeve të përgatitura nga këshilltarët ligjorë. Treguesi i Normës së Rendimentit të Këshilltarëve Ligjorë paraqitet në vlerën 229 relacione të përgatitura për këshilltar. I përlllogaritur sipas kolegjeve përkatës treguesi NR paraqitet në vlerën 278 çështje për këshilltar ligjor në kolegjin administrativ, 200 çështje për këshilltar ligjor në kolegjin civil dhe 220 çështje për këshilltar ligjor në kolegjin penal.




<i>Këshilltarë Ligjorë pranë Kolegjit Administrativ</i>	Nr. i çështjeve të përgatitura për vitin 2025
<i>Besmir Rrapaj</i>	319
<i>Elton Frashëri</i>	315
<i>Eranda Hysi</i>	316
<i>Gerti Shani</i>	322
<i>Griselda Leka</i>	311
<i>Iva Bregasi</i>	34
<i>Iva Zemani</i>	217
<i>Leonard Kryeziu</i>	325
<i>Olta Cenaj</i>	334

<i>Këshilltarët Ligjorë pranë Kolegjit Civil</i>	Nr. i çështjeve të përgatitura për vitin 2025
<i>Agim Korçari</i>	291
<i>Albana Misja</i>	349
<i>Alda Sadiku</i>	357
<i>Anlona Bodo</i>	239
<i>Dorinela Nikolli</i>	26
<i>Erolda Tarelli</i>	31
<i>Eva Hysko</i>	31


<i>Këshilltarët Ligjorë pranë Kolegjit Civil</i>	Nr. i çështjeve të përgatitura për vitin 2025
<i>Inesa Çela</i>	93
<i>Laureta Nezaj</i>	320
<i>Nertila Ndrejoni</i>	279
<i>Valjona Haxhiraj</i>	74
<i>Zef Macaj</i>	308

<i>Këshilltarët Ligjorë pranë Kolegjit Penal</i>	Nr. i çështjeve të përgatitura për vitin 2025
<i>Alfred Gjonpali</i>	295
<i>Edlira Llango</i>	100
<i>Egesta Ahmetaj</i>	260
<i>Elenita Myftari</i>	253
<i>Evriklejda Semani</i>	282
<i>Metush Meçka</i>	254
<i>Renis Sheshi</i>	84
<i>Romina Elezi</i>	235
<i>Sonila Hoxha</i>	224





Çështjet e mbartura dhe çështjet e prapambetura (backlog/stok)



Prej vitit 2021, vihet re një prirje në zbritje e çështjeve të mbartura, e cila vijon të qëndrojë e tillë edhe në vitin 2025. Çështjet e mbartura përfshijnë të gjitha çështjet e regjistruara në Gjykatë deri në 31 dhjetor 2025 dhe ende të pa gjykuara. Jo të gjitha çështjet e mbartura konsiderohen çështje të prapambetura. Deri më 31 dhjetor 2025 janë gjithsej 16,498 çështje të mbartura në pritje për gjykim, nga të cilat 4416 çështje administrative, 11.606 çështje civile dhe 476 çështje penale.


Në vitin 2019, volumi i çështjeve të mbartura pësoi dukshëm rritje, përkatësisht me 20% në vitin 2020 dhe 4% në vitin 2021. Për herë të parë ky tregues pësoi ulje në vitin 2022 me 12% krahasuar me këtë tregues në vitin 2021, me 18% në vitin 2023 dhe vijoi me 20% në vitin 2024. Aktualisht në vitin 2025, numri i çështjeve

të mbartura tregon qëndrueshmëri në prirjen në ulje prej 21% krahasuar me këtë tregues në vitin 2024. Nëse treguesi i vitit 2025 do të krahasohej me treguesin më të lartë, pra atë të vitit 2021, ulja do të llogaritej në 54%.

Për efekt të përllogaritjes së çështjeve të prapambetura, vlerësohet se deri në dhjetor 2025 përbëjnë çështje të prapambetura 14.081 çështje, pra ato çështje që deri më 31 dhjetor 2025, janë më të vjetra se 24 muaj, për çështjet civile dhe administrative dhe më të vjetra se 12 muaj për çështjet penale. Çështjet e prapambetura përbëjnë 85% të volumit të çështjeve të mbartura.


Lloji i çështjes	Çështje të prapambetura (më të vjetra se 24 muaj, për çështjet civile dhe administrative dhe më të vjetra se 12 muaj për çështjet penale)
Çështje Administrative	3446
Çështje Civile	10,521
Çështje Penale	114
Gjithsej	14,081

Volumi i çështjeve të prapambetura ka pësuar rënie të konsiderueshme krahasuar me përllogaritjet e bëra në korrik 2020, korrik 2021, dhjetor 2021, dhjetor 2022, dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe dhjetor 2025.




Duke filluar nga korriku i vitit 2020, sasia e çështjeve të prapambetura stok pësoi rënie, përkatësisht me 5% në korrik të vitit 2021, me 5 % në dhjetor të vitit 2021, 8% në dhjetor të vitit 2022, 18% në vitin 2023 dhe 22% në vitin 2024. Aktualisht në vitin 2025, numri i çështjeve të prapambetura tregon qëndrueshmëri në prirjen në ulje prej 24% krahasuar me po këtë tregues në vitin 2024. Të marra së bashku, nga korriku 2020 kur u regjistrua dhe shifra më e lartë e çështjeve të prapambetura e deri në dhjetor 2025, sasia e çështjeve të prapambetura, pësoi rënie me 60%.


Çështjet e prapambetura për nga natyra kategorizohen në: 75% civile, 24% administrative dhe 1% penale.




Sasia e çështjeve administrative të prapambetura në dhjetor 2025 pësoi rënie me 71% krahasuar me atë të çështjeve administrative të prapambetura në korrik të vitit 2020.




Grafiku pasues tregon numrin e çështjeve të prapambetura administrative, sipas vitit të regjistrimit dhe kohës së matjes së stokut në korrik 2020 dhe korrik 2021, në dhjetor 2022, dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe dhjetor 2025. Sikurse tregon edhe grafiku në matjet e dhjetorit 2022, çështjet me vit regjistrimi 2010-2015 nuk figurojnë më si pjesë e stokut. Në matjet e dhjetorit 2025, çështjet me vit regjistrimi 2017-2018 janë shqyrtuar pothuajse tërësisht duke hyrë në çështjet me vit regjistrimi 2019.




Sasia e çështjeve civile të prapambetura në dhjetor 2025 pësoi rënie me 40% krahasuar me sasinë e çështjeve civile të prapambetura në korrik të vitit 2020.




Grafiku më poshtë tregon numrin e çështjeve të prapambetura civile, sipas vitit të regjistrimit dhe kohës së matjes së stokut në korrik 2020 dhe korrik 2021, në dhjetor 2021, dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe dhjetor 2025. Sikurse tregon edhe grafiku në matjet e dhjetorit 2025, çështjet me vit regjistrimi 2010-2014 nuk figurojnë më si pjesë e stokut, ato me vit regjistrimi 2015 janë pothuajse përfunduar. Aktualisht, Kolegji Civil gjykon çështjet me vit regjistrimi 2016-2017.




Sasia e çështjeve penale të prapambetura në dhjetor 2025 pësoi rënie me 98% krahasuar me sasinë e çështjeve penale të prapambetura në korrik të vitit 2020.



Grafiku pasues tregon numrin e çështjeve të prapambetura penale, sipas vitit të regjistrimit dhe kohës së matjes së stokut në korrik 2020 dhe korrik 2021, dhe dhjetor 2022, dhjetor 2023, dhjetor 2024 dhe dhjetor 2025. Sikurse tregon edhe grafiku në matjet e dhjetorit 2025, çështjet me vit regjistrimi 2010-2021 nuk figurojnë më si pjesë e stokut, ato me vit regjistrimi 2022 janë pothuajse zero. Aktualisht, Kolegji Penal gjykon çështjet me vit regjistrimi 2023-2024.



Përqindjen më të madhe në volumin e çështjeve të prapambetura vijnë nga zënë çështjet e regjistruara në vitin 2019, ndërkohë që çështjet me vit regjistrimi më të hershëm dukshëm janë gjithmonë e më në zbritje.



Në korrik 2021, Gjykata e Lartë hartoi Planin e Veprimit për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, bazuar në planet strategjike të KLGJ për vitet 2019-2020, 2021-2023, “Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Gjykatës së Lartë”. Në këtë plan veprimi, nëpërmjet Synimit 3, “*Dhënia përparësi uljes së çështjeve të prapambetura dhe parandalimi i krijimit të stokut, në fokus të strukturave drejtuese të Gjykatës së Lartë*”, me mbështetjen e KLGJ dhe asistencën e vazhdueshme të partnerëve

ndërkombëtare, ka qenë hartimi i një metodologjie për përcaktimin e hapave që do të ndërmerren për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura.

Në vijim të miratimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), më pas mbështetur nga Departamenti i Shtetit, Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA në Shqipëri, Gjykata e Lartë është mbështetur me burime njerëzore, në funksion të reduktimit të numrit të çështjeve të prapambetura prej vitit 2020. Për shkak të ndryshimeve të politikave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në janar 2025, projekti i sipërpërmendur u ndërpre si pasojë e mungesës së financimit. Kjo ndërprerje solli pasojë të menjëhershme në kapacitetet operacionale të Gjykatës së Lartë, duke rritur ndjeshëm ngarkesën në procesin e kategorizimit dhe filtrimit paraprak, të cilat më parë mbështeteshin në asistencën teknike dhe logjistike të projektit. Si rezultat, Gjykata u përball me nevojën për të riabsorbuar vëllime të konsiderueshme pune brenda strukturave ekzistuese, duke theksuar edhe një herë rëndësinë e mbështetjes së qëndrueshme institucionale dhe burimeve adekuate për përmbushjen efektive të funksioneve të saj kushtetuese. Me qëllimin zbutjen e efekteve të menjëhershme të shpërndarjes së kapaciteteve të projektit, si edhe për shkak të eksperiencës së ndërtuar prej tyre përgjatë viteve të kaluara, Gjykata iu drejtua me një kërkesë KLGJ dhe Ministrisë së Financave, për alokimin e fondeve urgjente. Kjo kërkesë synonte financimin e këtyre kapaciteteve për një periudhë disa mujore, deri në krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm i cili do të mundësonte përballimin e ngarkesës në kuadër të filtrimit të çështjeve. Deri në fund të vitit 2025 kjo kërkesë nuk u përmbush me fondet buxhetore, gjë që ndikoi në ngarkesën aktuale të Gjykatës.

VEPRIMTARIA E ORGANEVE DREJTUESE

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ka qenë e orientuar për të kontribuar në çështjet thelbësore që lidhen me veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Lartë, dhe të organeve të saj drejtuese, duke zhvilluar mbledhje periodike, në të cilat gjyqtarët kanë diskutuar lidhur me ecurinë e procesit të evadimit të stokut në Gjykatën e Lartë dhe masat organizative që duhen marrë për reduktimin e tij, çështje të natyrës juridike, si dhe vendimmarrje të tjera jo-gjyqësore që sipas ligjit janë në kompetencë të saj. Ky organ i Gjykatës është mbledhur gjithashtu për të diskutuar dhe hartuar një opinion me shkrim lidhur me projektin e Kodit të ri Penal, ku u pasqyruan sugjerimet dhe kritikën e Gjykatës së Lartë lidhur me të. Materiali iu dërgua për njohje Ministrit të Drejtësisë.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3, datë 26.11.2025, vendosi deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit Asim Vokshi, për shkak të zgjedhjes së tij gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 4, datë 09.12.2025, vendosi miratimin e organizimit të ceremonisë së *Hapjes së Vitit Gjyqësor 2026*.

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve, me vendimin nr.2, datë 30.09.2025, miratoi zgjedhjen e z. Asim Vokshi, gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Gjykatës

Edhe gjatë vitit 2025, Këshilli i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar disa mbledhje në të cilat janë diskutuar dhe janë marrë vendime të rëndësishme, në përputhje me kompetencat ligjore, për veprimtarinë administrative të strukturave të Gjykatës së Lartë, si më poshtë:

- Vendimi nr. 6, datë 10.04.2025, për Miratimin e fazës së I-rë të ProjektBuxhetit të Gjykatës së Lartë për vitet 2026-2028;
- Vendimi nr.7, datë 10.04.2025, për Miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimin e vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr. 10, datë 27.06.2025, për krijimin e trupit gjykues të përkohshëm në Kolegjin Civil dhe caktimin në përbërje të tij të dy gjyqtarëve të Kolegjit Administrativ.
- Vendimi nr. 15, datë 10.10.2025, për disa ndryshime në vendimin nr. 6, datë 21.03.2024, “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit kolegji” .
- Vendime për rekrutimin e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor.

Në përputhje me përcaktimet ligjore që rregullojnë transparencën e punimeve të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës, është publikuar vendimi përkatës si dhe varianti i përmbledhur i procesverbaleve të mbledhjes, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Kryetari i Gjykatës

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka kryer të gjitha funksionet drejtuese me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të saj, si edhe përfaqësimin e institucionit në organet vendase e ndërkombëtare. Nëpërmjet urdhrave të nxjerrë prej tij është synuar përmirësimi i proceseve të punës së strukturave administrative të Gjykatës, koordinimi më i mirë mes tyre në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve gjyqësore.

Në kuadër të mirë administrimit të drejtësisë në Gjykatën e Lartë, Kryetari i është drejtuar disa herë KLGJ, me kërkesë për shtimin e numrit të nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe punonjësve me kontratë në Gjykatën e Lartë. Menjëherë pas përfundimit të projektit të INL-së i cili asistoi Gjykatën me përpunimin paraprak të dosjeve të *backlogut* nga nëpunës të cilët u specializuan në detyrë për këtë qëllim, u kërkuua vlerësimi i kontraktimit të specialistëve me kohë të pjesshme sipas VKM nr. 39, datë 24.01.2024. Më tej, duke vënë theksin tek situata gjithnjë e më e rënduar në gjykatat e apelit si dhe në Gjykatën e Lartë, Kryetari iu drejtua me një tjetër kërkesë të mbështetur nga dy gjykatat e apelit në vend, për marrjen e iniciativës për ndërhyrje ligjore me qëllim shtimin e kapaciteteve të gjykatave me staf administrativ për një periudhë 1 vjeçare, me qëllim uljen e numrit të çështjeve në pritje (dhjetëra mijëra në nivel apelesh), ngarkesën mesatare për gjyqtar, të cilat nuk mund të realizohen veçse me masa emergjente. Këto masa emergjente janë të domosdoshme për të përmirësuar kohëzgjatjen e gjykimit dhe për të shmangur shkeljet e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të cilat qëllim final kanë rritjen e besimit e publikut në sistemin e drejtësisë.

Edhe për vitin 2025, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor lidhur me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED), Kryetari i Gjykatës së

Lartë ka dhënë një mbështetje të vazhdueshme administrative, organizative dhe me burime njerëzore, me qëllim realizimin e detyrave funksionale të KED. Gjatë vitit 2025, Kryetari ka drejtuar edhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, krahas Gjykatës së Lartë dhe Kolegjit Administrativ.

Gjithashtu, Kryetari i Gjykatës së Lartë, në cilësinë *ex officio* të Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, thirri dhe drejtoi punimet e mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës, në të cilën u miratuan një sërë vendimesh për çështje të ndryshme që lidheshin me mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shkollës.

Kancelari

Kancelari në detyrë, si struktura përgjegjëse për menaxhimin e administrimit gjyqësor, ka marrë të gjitha masat administrative dhe organizative për të përmbushur detyrat funksionale në drejtim të koordinimit të punës së strukturave për përballimin e vëllimit të punës, hedhjen e shortit, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të statistikave gjyqësore, kryerjen e detyrave të deleguara nga Kryetari, mirëmbajtjen e godinës së Gjykatës, duke autorizuar përshtatjen e ambienteve të brendshme të saj dhe krijimin e kushteve të përshtatshme në punë, mbajtjen e vazhdueshme të kontakteve me KLGJ për çështje që lidhen me funksionimin e strukturave të Gjykatës, etj. Kancelari vijon ende të jetë i komanduar në këtë detyrë. Kryetari i Gjykatës së Lartë ka shprehur në vijimësi interesin për përshpejtimin e procesit të rekrutimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve për këtë pozicion, përkatësisht nga KLGJ dhe Shkolla e Magjistraturës, me qëllim që të përmbillet emërimi i kancelarit të përhershëm, sipas kritereve të parashikuara nga ligji për këtë qëllim.

VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE

Qendra e Dokumentacionit

Qendra e Dokumentacionit është një strukturë thelbësore ndihmëse e Gjykatës së Lartë, detyrat e së cilës janë analiza sistematike e jurisprudencës, përmes përzgjedhjes së kujdesshme të vendimeve gjyqësore më të rëndësishme dhe botimit të tyre në forma të ndryshme, hartimi i materialeve, si dhe kryerja e kërkimeve ligjore, në mbështetje të veprimtarisë vendimmarrëse të Gjykatës.



Analiza sistematike e jurisprudencës



Përzgjedhja e vendimeve gjyqësore më të rëndësishme



Botimi i vendimeve



Kërkime ligjore

Puna e Qendrës së Dokumentacionit vijoi edhe në vitin 2025 në drejtim të analizës së jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe pasurimit të vazhdueshëm të buletinit me vendime gjyqësore të rëndësishme dhe shpërndarjes së tij. Gjatë vitit 2025 është botuar edhe buletini tematik për secilin kolegji, sipas çështjeve më të shpeshta apo më të rëndësishme si pjesë e vendimmarrjes së Gjykatës¹⁶.

16. Buletini Tematik nr. 12- Vlerësimi financiar i pronave nga ATP dhe afatet e njoftimit sipas ligjit nr. 133/2015, të ndryshuar; Buletini Tematik nr. 11 “Mjetet e sigurimit në detyrimet kontraktore”; Buletin Tematik nr. 10 - Zbatimi i kushteve për lejimin e ekstradimit;

Përgjatë vitit 2025 Qendra e Dokumentacionit ka funksionuar me një strukturë prej 8 specialistësh, në pritje të plotësimit të strukturës në nivel drejtues, çfarë do të sjellë dhe rritjen e performancës dhe veprimtarisë administrative. Veprimtaria e deritanishme e Qendrës është drejtuar dhe realizuar në bashkëpunim të ngushtë me znj. Arta Vorpsi, drejtore e kabinetit të Kryetarit, në Gjykatën e Lartë. Me qëllim plotësimin e strukturave drejtuese të Qendrës, përgjegjës sektori dhe drejtor, i është kërkuar KLGJ shtimi i numrit të kësaj strukture, e cila ka mjaft nevojë për një organizim më të mirë, pas një periudhe 4 vjeçare të funksionimit të saj sipas pritshmërisë. Plotësimi i Qendrës me drejtuesit përkatës (përgjegjës sektori dhe Drejtor) do t'i jepte një hov cilësor kësaj njësie, e cila tashmë mund të konsiderohet si e konsoliduar dhe duhet të kalojë në një stad më të lartë profesionalizmi, me qëllim që t'i përgjigjet sa më mirë kërkesave të trupës gjyqësore.

Nëpunësit e Qendrës janë trajnuar sipas planit vjetor të trajnimit, përmes seminareve të posaçme të organizuara në bashkëpunim me partnerët e huaj, me të cilët Gjykata e Lartë ka tashmë marrëveshje, si Këshilli i Evropës dhe EU4Justice. Falë këtyre aktiviteteve të shtrira përgjatë vitit 2025, vërehet një përmirësim i cilësisë së punës dhe reagim me efikasitet ndaj kërkesave të trupës gjyqësore për identifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë shqiptare dhe atyre homologe. Ndihma e partnerëve ndërkombëtarë ka shërbyer për forcimin e kapaciteteve, si dhe përmirësimin e aftësive teknologjike të Qendrës së Dokumentacionit.

Në fokusin e qendrës gjatë vitit 2025 ka qenë në mënyrë të veçantë ndjekja e praktikës së Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë analizuar me kujdes në funksion të efekteve që ato kanë për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në tërësi, konstatohet një rritje e përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit për kryerjen e detyrave të përditshme të nëpunësve të kësaj strukture, në kërkimin e praktikës gjyqësore, përgatitjen e materialeve studimore, pasurimin e bibliotekës së institucionit, si dhe publikimin e vendimeve gjyqësore. Megjithatë shtrohet ende nevoja e pajisjes me burime kërkimi në biblioteka dhe arkiva online.

Baza e të Dhënave të vendimeve të indeksuara të Gjykatës së Lartë “JUDIX”, ka vijuar të popullohet nga specialistët e Qendrës. Ky arkiv elektronik i vendimeve të Gjykatës së Lartë, ku vendimet kategorizohen sipas kriterëve dhe të dhënave specifike, me qëllim lehtësimin e kërkimit të jurisprudencës së gjykatës nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm, është tashmë funksional. Pronësia e databazës iu transferua përfundimisht Gjykatës së Lartë nga Fondacioni gjerman IRZ në 22 Janar të vitit 2025. Baza e të dhënave lejon kërkimin e vendimeve me titull, fjalë kyçe, bazë ligjore, relator, trupë gjyqësore, palë, datë vendimi, numër vendimi, maksimum dhe përmbledhje. JUDIX popullohet me vendime në mënyrë vazhduese dhe aktualisht përdoret nga përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të gjykatës.

Aktualisht, deri në fund të vitit 2025, janë hedhur mbi 2000 vendime të

Gjykatës së Lartë, çka shënon një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2024, i cili u përmbyll me rreth 600 vendime. Objektivi i Qendrës së Dokumentacionit është që ky numër të rritet edhe më tej, me përrreth 3000 vendime në përfundim të vitit 2026, duke e bërë kërkimin në databazë më të thelluar dhe ezaurues për nevoja të institucionit, e po ashtu edhe të përdoruesve të jashtëm të cilët mund të jenë vazhdimisht në kontakt me vendimmarrjet e përzgjedhura të Gjykatës së Lartë ndër vite. Gjithashtu, po shtohet edhe një rubrikë e posaçme e e-biblioteka, ku do të hidhen materiale ndihmëse, kërkimore të përgatitura nga Qendra, në funksion të referimit të tyre nga gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës.

Aktualisht, në databazën “JUDIX” janë abonuar 633 përdorues, të cilët mund të aksesojnë vendimmarrjet e nevojshme duke plotësuar fushat e kërkimit.

Një projekt i ri, me fokus popullimin e databazës me rritëm më të shpejtë, ishte dhe atashimi 3-mujor pranë Qendrës së Dokumentacionit, i studentëve të përzgjedhur të Fakultetit të Drejtësisë, të cilët dhanë kontributin e tyre në përzgjedhjen e një pjese të vendimeve ndër vite, duke u trajnuar nga nëpunësit e Qendrës për nxjerrjen e metadatave më të rëndësishme të vendimeve. Kjo praktikë dha rezultate pozitive, gjë që inkurajon vijimin e saj edhe në vitet pasuese. Nisur nga kjo eksperiencë tejet pozitive, në objektivat e planifikuara për vitin 2026, Qendra e Dokumentacionit synon vijimin e programit ekzistues me një kurrikul të mirëfilltë trajnimi.

Kërko Pasqja Kohëzotë

Totale i Vendimeve - 1902

Numri i Aktit	Fasha e së Drejtës	Titulli Vendimit	Veprimi
11217-04049-00-2017	E drejtë civile E drejtë procedurale civile E drejtë kontraktore	Ricorja e pjeshme e shqyrtimit gjyqësor në fazën e gjyqimit në apel për të marrë prapë e të në mundësi të riplotimit të palëve.	
31003-02153-00-2017	E drejtë administrative	Në rastin e moszotpusarimit të beocës, kreditorit të njohur para paditëse nuk mund të konsiderohet se ka qenë në vonesë për mospagimin e detyrimeve të atit.	
11243-01576-00-2017	E drejtë civile E drejtë e pronësisë E drejtë procedurale civile	Anulimi i pjesëshmë të vendimit të ZDRKP për shkak mbivendosja pasurite	


Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Qendrës së Dokumentacionit ka qenë kryesisht e fokusuar në shpërndarjen e jurisprudence të Gjykatës së Lartë përmes buletinit informativ elektronik të Gjykatës së Lartë. Kështu, praktikuesve të së drejtës dhe çdo individ u jepet mundësia që të njihen me praktikën më të fundit të zgjedhur të Gjykatës si dhe të GJEDNJ kundër Shqipërisë, duke përfshirë edhe aktivitetet më të rëndësishme të institucionit. Gjatë Vitit 2025, Qendra e Dokumentacionit ka përgatitur dhe shpërndarë për lexuesit 8 Buletinë Periodikë dhe 3 Buletinë Tematikë. Vlen të theksojmë se, në total janë nxjerrë 41 numra përgjatë viteve 2022-2025. Aktualisht numri i abonentëve në buletin elektronik është 2820, ndërsa lexuesve i janë dërguar 1047 vendime gjyqësore (nga të cilët 926 të Gjykatës së Lartë dhe 121 të GJEDNJ kundër Shqipërisë).

Duke marrë parasysh interesin e shtuar sa i takon Buletinëve Tematikë nga lexuesit, në fokusin e Qendrës së Dokumentacionit për vitin 2026 do të jetë edhe publikimi më i shpeshtë i tyre për secilin kolegji, e po ashtu edhe përditësimi i

atyre aktualë. Nga muaji dhjetor ka nisur përditësimi i Buletinit Periodik edhe me jurisprudence të Gjykatës së Kasacionit Italian dhe Gjykatës së Kasacionit Francez. Kjo praktikë pritet të vazhdojë përgjatë vitit 2026 dhe të zgjerohet me vendimmarrje të gjykatave të vendeve të tjera evropiane.

Sektori i publikimit dhe i statistikave

Procesi i publikimit të vendimeve gjyqësore është specifik dhe ka një rëndësi të madhe publike, pasi nuk lidhet vetëm me rritjen e nivelit të transparencës së veprimtarisë së Gjykatës së Lartë, por edhe me edukimin e profesionistëve të së drejtës dhe publikut në tërësi lidhur me njohjen e praktikës gjyqësore. Aktualisht, vendimet gjyqësore të Gjykatës së Lartë publikohen të plota në faqen zyrtare të saj, e cila është lehtësisht e aksesueshme. Në këtë aspekt, sektori i publikimit dhe i statistikave ka si qëllim të vetin hartimin dhe përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të bazës së të dhënave të vendimeve gjyqësore në formë të plotë dhe të shkurtuar (të përmbledhur), sipas kritereve shkencore.



Ky sektor i Qendrës ka mundësuar shpërndarjen e buletinit informativ elektronik të Gjykatës, duke përzgjedhur vendimet më të rëndësishme sipas këtij rendi:

- vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- vendime njëesuese të tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë;
- vendime me risi në interpretim (për zhvillimin e praktikës gjyqësore) nga të tre kolegjet e Gjykatës së Lartë;
- vendime të tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë që shqyrtojnë problematikat më të shpeshta të konstatuara në vendimarrjet e gjykatave më të ulëta;
- vendime të shumëllojshme për nga lënda dhe objekti, të dhëna prej tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë;
- vendime juridiksioni/kompetencë të tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë;
- vendime të tre kolegjeve mbi gjykimet e posaçme;
- vendime për kontroll incidental të nisur nga Gjykata e Lartë.

Një veprimtari e rëndësishme e këtij sektori të Qendrës lidhet me statistikat. Gjatë vitit 2025 Gjykata e Lartë ka përpunuar dhe dërguar këto statistika të listuara si vijon:

- Statistikat tematike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Institutit të Statistikave. Statistikat i janë dërguar këtyre institucioneve për çështjet e ardhura, çështjet e gjykuara, dhe çështjet në pritje për t'u gjykuar, të ndara me kategori të caktuara. Këto statistika nxirren 4 herë në vit, për periudhat 3-mujore, si dhe vjetore;

- Statistikat për track recordet e veprave penale të ndërlidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar për Ministrinë e Drejtësisë, çdo 3 muaj përgjatë vitit 2025.

Gjithashtu, në kuadër të misionit “Peer Mission”, në lidhje me Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin për vitin 2025, janë përcjellë të dhënat në lidhje me 8 çështje mbi korrupsionin e nivelit të lartë (duke përfshirë dhe korrupsion në prokurimet publike), shpërdorimin e detyrës, krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, të cilat janë të gjykuara nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për periudhën 2022-2025.

Sektori i kërkimit ligjor dhe bibliotekës

Ky sektor ka në fokus të veprimtarisë së tij kryesisht studimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës, kërkimin, gjetjen e literaturës dhe doktrinës juridike, evidentimin e rasteve të ngjashme të trajtuara nga jurisprudenca e huaj, në ndihmë të Kolegjeve të Gjykatës dhe Kolegjeve të Bashkuara për çështjet që kanë të bëjnë me njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, janë përgatitur përmbledhje të shkurtra të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut dhe Luksemburgut, me qëllim përditësimin e Gjykatës së Lartë me praktikën e tyre gjyqësore, si dhe mundësinë e zhvillimit apo pjesëmarrjes në konferenca shkencore.

Ndryshimet kushtetuese e ligjore kanë riparë rolin e Gjykatës së Lartë përsa i përket njësimit të praktikës gjyqësore. Në këtë aspekt, kërkimi ligjor, studimi, analizimi dhe përpunimi i vendimeve gjyqësore është aktivitet i rëndësishëm për njësimin e praktikës gjyqësore, garantimin e sigurisë juridike përmes

interpretimit uniform të ligjit si dhe të përhapjes së informacionit dhe kulturës juridike në përgjithësi. Ky sektor ka pasqyruar gjendjen e jurisprudencës së Gjykatës për çështje të caktuara duke ndihmuar në rritjen e efektshmërisë, qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore dhe uljen e numrit të konflikteve gjyqësore që vijnë në Gjykatën e Lartë. Përgjatë vitit 2025, vërehet një rritje sasiore dhe cilësore e materialeve të përgatitura nga ky sektor. Disa nga punimet paraqiten si më poshtë:

- analizë e përmbledhur e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë konstatuar problematika lidhur me vendimarrjet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, përgjatë viteve 2016–2025 (material në përditësim);
- përmbledhje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të lidhura me institutin e kontrollit incidental, të parashikuar nga neni 145 i Kushtetutës, përgjatë viteve 2016–2025 (material në përditësim);
- material lidhur me statusin procedural të kërkuarit në gjykimin e rishikimit;
- material lidhur me masat e sigurimit personal, jurisprudencën vendase dhe vështrim i praktikës evropiane;
- material lidhur me pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit;
- material mbi zbatimin e parimit të reciprocitetit mes shteteve palë të konventës, në marrëdhëniet dhe procedurat e ekstradimit;
- material për kallëzimin e rremë penal të funksionarit publik;
- material për encrochat, origjina dhe praktika gjyqësore;
- material mbi aspektet e juridiksionit, ligjin e zbatueshëm, njohjen,

zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore, masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe vendqëndrimin e zakonshëm të të miturit;

- përmbledhje të vendimeve unifikuese, ndryshuese dhe interpretative të Gjykatës së Lartë mbi dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, përfshirë edhe ato që lidhen me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi këto dispozita;
- kërkim i jurisprudencës për shumë institute të ndryshme të së drejtës administrative, penale dhe civile.

Vlen të theksohet se janë kryer disa punë kërkimore në lidhje me pyetjet e parashtruara nga Rrjeti i Gjykatave të Larta, i krijuar në kuadër të Këshillit të Evropës dhe GJEDNJ, ku Gjykata e Lartë është anëtare.



Po ashtu, një nga detyrat e Sektorit të Kërkimit Ligjor dhe Bibliotekës ka qenë pasurimi i bibliotekës së Gjykatës së Lartë me literaturë bashkëkohore. Gjatë këtij viti janë shtuar titujt e librave në versionin fizik, si dhe është përditësuar baza ligjore për nevojat e punës. Duhet theksuar se mjedisi aktual dhe hapësira e bibliotekës nuk është plotësisht e përshtatshme për ruajtjen e fondit të librave dhe aq më pak për shfrytëzimin e plotë të saj nga përdoruesit. Mbetet përparësi edhe për vitin 2026 pasurimi i fondit me botime bashkëkohore në gjuhë të huaj në fushën e së drejtës civile, administrative dhe penale, kryesisht me karakter krahasimor. Riorganizimi i bibliotekës së institucionit në vitin 2025, për ta sjellë në kushte më të mira fizike dhe për të lehtësuar aksesin brenda saj nga çdo i interesuar, vazhdoi po ashtu edhe gjatë vitit 2026, dhe si rrjedhojë është krijuar mundësia për të aksesuar titujt, të cilët gjenden fizikisht në bibliotekë, sipas kërkesave apo nevojave. Po kështu, janë skanuar disa nga titujt më të rëndësishëm brenda saj, si dhe disa nga aktet e vjetra juridike më të rëndësishme. Si objektiv për vitin 2026, do të vlerësohet mundësia e krijimit të një biblioteke online apo arkivi të digjitalizuar, ku titujt e skanuar të organizohen sipas natyrës së tyre e po ashtu të vijojë puna me plotësimin e këtij fondi arkivor me akte të vjetra të cilat shërbejnë si mjet për ruajtjen e trashëgimisë juridike të Gjykatës së Lartë.

Me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare me të cilat Gjykata e Lartë bashkëpunon dhe me synimin e rritjes së efektivitetit të kësaj njësie administrative janë ndjekur trajnimet dhe konferencat e mëposhtme:

<i>Periudha</i>	<i>Trajnimi</i>	<i>Informacioni i përfutur</i>
<i>Shkurt 2025</i>	Trajnim praktik mbi përmirësimin e kërkimit ligjor dhe hartimin e vendimeve gjyqësore, nga z. Gianluigi Pratola, Zv/ Prokuror i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë të Kasacionit. Mundësuar nga Këshilli i Evropës	<i>Ky trajnim përmirësoi harmonizimin gjyqësor dhe nxjerrjen në pah të metodologjive të avancuara kërkimore të frymëzuara nga modeli i Gjykatës së Lartë të Kasacionit në Itali. Ky program nxiti zbatimin e praktikave më të mira në punën e GJL-së sa i takon përmirësimit të teknikës së hartimit të maksimës, përmbledhjeve dhe po ashtu edhe të fjalëve kyçe.</i>
<i>Shtator 2025</i>	Forumi i Harmonizimit, mbi zbatimin uniform dhe koherent të praktikave gjyqësore vendase në përputhje me standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mundësuar nga Këshilli i Europës	<i>Ky forum ndau perspektiva mbi zbatimin e nenit 6 të KEDNJ dhe standardeve evropiane mbi procesin e rregullt ligjor, kohëzgjatjen e procedurave dhe mjetet juridike efektive. Ky aktivitet hodhi një hap të rëndësishëm drejt një gjyqësori më të unifikuar, efikas dhe në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut.</i>
<i>Tetor 2025</i>	Vizitë studimore pranë Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor të Portugalisë, mundësuar nga Këshilli i Evropës.	<i>Synimi i vizitës studimore ishte përmirësimi i praktikave të menaxhimit të çështjeve dhe kërkimit gjyqësor, në përputhje me standardet evropiane.</i>

Nëntor 2025	Webinar me temë “Mbrotjtja e të drejtave të të tjerëve në internet” i organizuar nga Rrjeti i Gjykatave të Larta pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.	Në webinar u trajtuan tema si mbrotjtja nga gjuha e urrejtjes, e drejta për jetën private, balancimi i të drejtës për jetën private dhe lirisë së shprehjes.
Nëntor 2025	Trajnim për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, mundësuar nga EU4Justice.	Ky trajnim interaktiv, i mbështetur në praktikat më të mira nga Gjykata Supreme e Kasacionit Italian, u përqendrua në harmonizimin gjyqësor, metodologjitë e kërkimit dhe qasjet e strukturuar për vendime të qarta dhe koherente.

Redaktori gjuhësor

Pjesë e Qendrës së Dokumentacionit është edhe redaktori gjuhësor, i cili është i ngarkuar me redaktimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera të saj. Nisur nga detyrat e redaktorit, si dhe me mbështetjen e kabinetit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, janë organizuar tryeza me këshilltarët ligjorë me qëllim shkëmbimin e ideve lidhur me përmirësimin e gjuhës së përdorur në përmbajtjen e vendimeve. Janë përcaktuar disa rregulla standarde për respektimin e të cilave duhet të kujdesen gjyqtarët, këshilltarët ligjorë, redaktori gjuhësor dhe sekretaria, përpara se vendimi i arsyetuar t’u shpërndahet palëve apo të publikohet. Redaktori kontribuon edhe për mbarëvajtjen e punës edhe në bibliotekën e Gjykatës së Lartë. Për vitin 2026, synohet shtimi i kapaciteve të

redaktorëve gjyqësorë, për shkak të volumit të madh të vendimeve të marra nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë. Gjithashtu nisur nga përditësimi i gjuhës shqipe përmes fjalorit të ri shqip-shqip, prodhim i Akademisë së Shkencave e vitit 2024, synohet zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme njohëse për tu përditësuar me ndryshimet e fjalorit për stafin e gjykatës (ndihmësit ligjorë dhe sekretaria gjyqësore)

Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë

Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun (Median) dhe me Jashtë (DMMPJ), gjatë vitit 2025, ka ushtruar veprimtarinë e saj në përmbushje të plotë të detyrave të ngarkuara, në përputhje me objektivat funksionale. Gjatë kësaj periudhe, shërbimet e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median janë realizuar me profesionalizëm, korrektësi dhe përgjegjshmëri, duke garantuar zbatimin e të drejtës për informim, rritjen e transparencës së veprimtarisë institucionale të Gjykatës së Lartë, si dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

DMMPJ ka mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe të strukturuar me median dhe publikun, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit institucional, duke siguruar një trajtim të barabartë, objektiv dhe jodiskriminues për të gjithë të interesuarit. Janë zhvilluar takime dhe komunikime informuese me përfaqësues të mediave, të cilët janë vënë në dijeni në mënyrë të rregullt mbi aktivitetet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, veprimtarinë e kolegjeve penale, civile dhe administrative, seancat gjyqësore, si dhe mbi aktivitetet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED).

Informacioni institucional është pasqyruar në kohë reale në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al, në rubrikën e dedikuar Marrëdhënieve me Publikun (Median), duke forcuar transparencën dhe aksesin e publikut në informacionin zyrtar. Në funksion të afërimit më të drejtpërdrejtë me publikun, rrjetet sociale zyrtare të Gjykatës së Lartë (Facebook, LinkedIn dhe YouTube) janë përdorur në mënyrë aktive dhe të qëndrueshme gjatë vitit 2025, për publikimin e njoftimeve, aktiviteteve, vendimmarrjeve dhe informacioneve me interes publik, duke kontribuar në rritjen e shpejtësisë së informimit dhe të ndërveprimit institucional me qytetarët.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar vazhdimit dhe konsolidimit të nismës “*Gjykata e Hapur*” (Open Court), e cila synon zgjerimin e aksesit të publikut në institucionin e Gjykatës së Lartë. Kjo nismë u ka mundësuar qytetarëve, studiuesve, praktikantëve të së drejtës, studentëve dhe nxënësve të shkollave të ndjekin seanca gjyqësore ose të vizitojnë institucionin, përmes një aplikimi të thjeshtë elektronik. Gjatë vitit 2025, interesi i publikut për këtë nismë ka vijuar të rritet, duke reflektuar besim dhe kërkesë më të madhe për transparencë dhe njohje të funksionimit të sistemit gjyqësor.

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun e Median

Viti 2025, për Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun ka qenë i fokusuar tek mbajtja e marrëdhënieve të ngushta me publikun. Përpunimi i kërkesave dhe informacionit ka qenë një nga objektivat kryesore të punës së përditshme të sektorit, duke përfshirë jo vetëm dhënien e informacionit të kërkuar nga publiku, por gjithashtu angazhimin serioz në edukimin dhe orientimin e

përdoruesve në lidhje mënyrat e qasjes ndaj informacionit. Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm ka qenë orientimi i përdoruesve në përdorimin e faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, me qëllim lehtësimin e kërkimit të informacionit duke promovuar sugjerimet konstruktive.

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median ka funksionuar si një pikë kyçe kontakti për publikun, duke ofruar informacion dhe mbështetje gjatë orarit të përcaktuar. Ajo ka orientuar përdoruesit e gjykatës, duke u përgjigjur me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike kërkesave nga individë dhe institucione, si dhe duke i orientuar saktë ata drejt zyrave të tjera të administratës gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Një nga shqetësimet e konstatuara gjatë veprimtarisë vjetore lidhet me nivelin e lartë të ngarkesës emocionale dhe tensionit me të cilin paraqiten shpesh përdoruesit e shërbimeve të gjykatës pranë sektorit të marrëdhënieve me publikun. Kjo situatë, e diktuar nga natyra e ndjeshme e proceseve gjyqësore, pritshmëritë e larta për informim dhe mungesa e njohurive të posaçme mbi ligjin, krijon sfida të vazhdueshme në komunikimin me qytetarët dhe rrit kërkesën për angazhim të shtuar profesional dhe njerëzor nga ana e stafit. Këto situata të cilat nuk janë raste të izoluara janë përballuar nga stafi përgjegjës jo vetëm me kompetencë profesionale dhe procedurale, por edhe aftësi të zhvilluara komunikimi, empati dhe kujdes të shtuar, me qëllim garantimin e një shërbimi korrekt, dinjitoz dhe në përputhje me standardet institucionale të gjykatës. Megjithatë, duke marrë shkas nga rritja e rasteve të tilla, paraqitet nevoja për forcimin e kapaciteteve mbështetëse, si në drejtim të burimeve njerëzore ashtu edhe të trajnimeve të specializuara në komunikim

dhe menaxhim të situatave me ngarkesë emocionale. Gjatë vitit 2025, janë trajtuar gjithsej 852 kërkesa, ankesa dhe shkresa (deri më 04.12.2025), më shumë se gjysma e të cilave janë paraqitur përmes postës elektronike. Ky fakt thekson rritjen e komunikimit përmes kësaj platforme, e cila ka siguruar një qasje më të shpejtë dhe pa kosto për përdoruesit, duke forcuar besimin se kjo mënyrë komunikimi është efektive dhe e besueshme. Bashkëpunimi i ngushtë i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun me sektorë të tjerë të administratës, sidomos me Drejtorinë e Administratës Gjyqësore dhe atë të Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë, ka mundësuar ofrimin e një shërbimi më të plotë dhe një ndjekje më efikase të kërkesave dhe ankesave. Ky bashkëpunim ka kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ka lehtësuar ndjekjen e çështjeve, duke siguruar një rrjedhë të pandërprerë dhe transparente të informacionit dhe kërkesave.

Përveç kësaj, është vënë re se disa përdorues kanë hasur vështirësi në gjetjen e informacionit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, një problematikë që është adresuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë. Si rezultat, po punohet për përmirësimin e faqes, duke shtuar opsione më praktike për përdoruesit dhe duke mundësuar një qasje më të lehtë dhe më efikas në të ardhmen.

Në përpjekje për të ofruar një shërbim edhe më të avancuar, është planifikuar që deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, informacioni për çdo çështje gjyqësore të jetë i centralizuar në një vend të caktuar, i cili do të përditësohet në përputhje me zhvillimet e çështjes. Ky hap do të lehtësojë procesin për palët ndërgjyqësore të interesuara, duke u

mundësuar atyre qasje në informacionin e kërkuar më lehtë dhe shpejtë në lidhje me çështjet e tyre, ndërkohë që informacioni më i gjerë për grupet e tjera të interesuara, si avokatët dhe studiuesit etj., do të vazhdojë të jetë i disponueshëm.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit në Gjykatën e Lartë ka trajtuar gjithashtu kërkesa të bazuara në ligjin nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, duke ofruar përgjigje brenda afateve ligjore dhe pa kosto. Gjatë vitit 2025, janë trajtuar gjithsej 33 kërkesa (deri në datë 04.12.2025) në përputhje me këtë ligj, duke siguruar që përdoruesit të kenë qasje në informacion në mënyrë të shpejtë dhe të saktë. Në përpjekje për të ofruar shërbim të kujdesshëm dhe efikas, janë marrë masa për të ndihmuar përdoruesit që vijnë nga qytete të largëta, duke i orientuar ata në përdorimin e telefonit si mjet alternativ për të marrë informacionin që u nevojitet. Kjo ka garantuar që asnjë përdorues të mos mbetet pa mbështetje, pavarësisht kufizimeve të mundshme teknologjike. Ndërveprimi i publikut dhe përdoruesve të gjykatës me zyrën e marrëdhënieve me publikun, besimi i krijuar i cili faktohet nga reagimi verbal dhe i shkruar përveçse janë një tregues i punës së mirë shërbejnë se motivues për sfidat e radhës e përmirësimin e shërbimit në vazhdim. Sektori i Marrëdhënieve me Publikun ka bërë progres të dukshëm në vitin 2025, duke ofruar një shërbim të kujdesshëm, të shpejtë dhe pa kosto për publikun. Puna e kësaj zyre ka përfshirë jo vetëm përmirësimin e komunikimit dhe qasjen ndaj informacionit, por edhe një angazhim të vazhdueshëm për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe institucioneve. Ky angazhim dhe bashkëpunim ndërinstitucional do të vazhdojë të jetë një faktor kyç në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e informacionit të duhur për të gjithë përdoruesit.

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë ka përmbushur me sukses detyrimet dhe objektivat gjatë vitit 2025, duke mbështetur funksionimin dhe misionin e Gjykatës së Lartë në drejtim të përfaqësimit të denjë të institucionit jashtë vendit. Sektori ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, si dhe në forcimin e bashkëpunimit me institucione homologe dhe organizma ndërkombëtare, duke kontribuar në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Gjykatës së Lartë.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme për vitin 2025 ku Gjykata e Lartë ka marrë pjesë mund të përmendim: Ceremoninë e Hapjes së Vitit Gjyqësor të GJEDNJ-së (Strasburg, 31 janar 2025); Takimin e 16-të të Task Forcës për Aksesin në Drejtësi në zbatim të Konventës së Aarhus-it, organizuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE në Gjenevë, 18-19 shkurt 2025); Forumin e Tretë të Barazisë Gjinore për Ballkanin Perëndimor organizuar nga AIRE Centre (Shkup, 7 mars 2025); Kongresin e XV-të i Shoqatës IASAJ (Shoqata Ndërkombëtare e Juridikioneve të Larta Administrative) në Santiago, Kili (2-4 prill 2025); Kongresin Botëror të Ligjit (Republikën Domenikane, më 4-6 maj 2025); Forumin e SCN (Rrjetit të Gjykatave të Larta të GJEDNJ-së (Strasburg, 5-6 qershor 2025); Kongresin e VIII i AHJUCAF, organizuar në partneritet me Gjykatën e Lartë të Marokut dhe Organizatën Botërore të Frankofonisë (Rabat, 2-4 korrik 2025); Forumin e harmonizimit mbi zbatimin uniform dhe koherent të praktikave gjyqësore vendase në përputhje me standardet e GJEDNJ-së, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës (Durrës, 18-19 shtator 2025); Konferenca Vjetore e Institutit ELI (Vjenë, 22-24 shtator 2025);

Vizitën studimore në Gjykatën e Lartë të Portugalisë, mbështetur nga Këshilli i Evropës (Lisbonë, 6-9 tetor 2025); Konferencën Vjetore të Rrjetit të Kryetarëve të Gjykatave të Larta të BE-së (Hagë, 13-15 nëntor 2025); Konferencën e 2-të Ndërkombëtare mbi Drejtësinë, me ftesë të Ministrit të Drejtësisë të Mbretërisë së Arabisë Saudite (Riad, 23-24 nëntor 2025), etj.

Në funksion të shkëmbimit të përvojave dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet institucioneve gjyqësore të rajonit, një nga arritjet më të rëndësishme të vitit 2025 ka qenë rikthimi për herë të dytë pas 10- vitesh i Konferencës së Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore. Kjo konferencë u zhvillua në Vlorë, më 9-10 qershor 2025, nën kujdesin e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin CEELI duke regjistruar pjesëmarrjen e 11 delegacioneve nga vendet e rajonit dhe më gjerë.

Një ngjarje që ka shënjuar vitin 2025, ka qenë pjesëmarrja e Gjykatës së Lartë me një delegacion gjithëpërfshirës në Kongresin Botëror të Ligjit në Santo Domingo, Republikën Domenikane, më 4-6 maj 2025, me ftesë të Kryetarit të Shoqatës Botërore të Juristëve, z. Javier Cremades. Gjatë këtij aktiviteti, Kryetari i Gjykatës së Lartë, gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë kontribuan aktivisht në disa panele të kongresit, duke prezantuar përvojën dhe zhvillimet e sistemit shqiptar të drejtësisë. Përmes kësaj pjesëmarrje, Gjykata e Lartë afirmoi rolin e saj si një aktor aktiv dhe kontribuues në debatin ndërkombëtar mbi sfidat dhe zhvillimet në fushën e drejtësisë, duke forcuar njëkohësisht bashkëpunimin ndërinstitutional dhe shkëmbimin e përvojave me sisteme të tjera ligjore.

Gjithashtu, në kuadër të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me Shoqatën ACA-Europe, u dha një kontribut i rëndësishëm në organizimin dhe pjesëmarrjen e Gjykatës së Lartë në një sërë aktivitetesh ndërkombëtare, ndër të cilat përfshihen: Seminari i organizuar në bashkëpunim me Këshillin e Shtetit Holandez dhe Këshillin e Shtetit Belg (Hagë, 17–18 mars 2025); Asambleja e Përgjithshme dhe Seminari i ACA-Europe, në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë Administrative të Finlandës (Helsinki, 25–27 maj 2025); si dhe Seminari i ACA-Europe, në bashkëpunim me Këshillin e Shtetit Grek (Athinë, 10–11 nëntor 2025).

Në kuadër të anëtarësisë në Rrjetin e Gjykatave të Larta të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, Gjykata e Lartë ka marrë pjesë në publikimin e librit¹⁷ të përvjetorit të Rrjetit, ku me punimet e pikave të kontaktit të Gjykatës së Lartë është reflektuar eksperiencia dhe përfitimet nga Rrjeti. Po në kuadër të kësaj anëtarësie Gjykata e Lartë ka ndërmarrë për herë të parë një iniciativë për kërkimin e praktikave më të mira nga gjykatat e larta pjesëmarrëse në rrjet lidhur me pasojat juridike që rrjedhin nga nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet që lidhen me vendbanimin e zakonshëm të fëmijëve në një shtet tjetër. Kjo praktikë erdhi si rezultat i çështjeve të shtruar për njësim në Kolegjin Civil, dhe solli përgjigje nga rreth 30 vende të ndryshme të Këshillit të Europës. Kjo iniciativë përveç se ndihmon harmonizimin e jurisprudencës me atë të vendeve të Këshillit të Europës synon dhe rritjen e shkëmbimit horizontal mes gjykatave të larta.

17. The Superior Courts Network - A community of practice in the service of justice (2025)

Lidhur me mbështetjen e përfaqësimit të Gjykatës së Lartë në aktivitete ndërkombëtare, janë përgatitur dhe ndjekur me kujdes korrespondenca me organizatorët dhe institucionet partnere, shkresat zyrtare, letrat e bashkëpunimit dhe dokumentacioni përkatës për të siguruar një pjesëmarrje të suksesshme të Kryetarit, gjyqtarëve dhe stafit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, Sektori është angazhuar plotësisht në përkthimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe materialeve juridike sipas kërkesave. Në mënyrë të veçantë, Sektori ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përkthimin e pyetësorëve dhe studimeve, në përputhje me kërkesat e gjykatave homologe, evropiane dhe partnerëve. Sektori ka planifikuar dhe realizuar me sukses të gjitha veprimet logjistike të nevojshme, duke përfshirë udhëtimet ajrore dhe tokësore, akomodimin, transportin dhe procedurat e vizave, për të garantuar një lehtësim maksimal për pjesëmarrësit.

Sektori ka ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet për forcimin e bashkëpunimit me gjykatat homologe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim zhvillimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira dhe ngritjen e standardeve të përbashkëta në fushën e drejtësisë.

Vlen për t'u theksuar forcimi i bashkëpunimit me Gjykatën e Lartë të Kasacionit të Italisë, Kryetari i shoqëruar nga një delegacion ka marrë pjesë në Ceremoninë e Hapjes së Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë, si dhe ka zhvilluar takime të tjera zyrtare (Romë, 23-24 janar 2025), duke nënshkruar një memorandum bashkëpunimi dypalësh. Në vijim në 2026 do të organizohet në Shqipëri një Tryezë e Rrumbullakët bashkëpunimi, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve italianë.

Në vijim të bashkëpunimit me gjyqësorin britanik, u zhvillua një Trajnim i përbashkët për Njësinë Ligjore të Gjykatës së Lartë në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe Zyrën Gjyqësore të Anglisë dhe Uellsit, nën drejtimin e gjyqtarëve britanikë, me fokus përmirësimin e cilësisë së hartimit të vendimeve gjyqësore, përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe përdorimit të qasjes analitike në argumentimin ligjor (Tiranë, 10 prill 2025).

Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal përmes organizimit të aktiviteteve të nivelit të lartë. Veçanërisht, sektori ka kontribuar në organizimin e vizitës zyrtare të delegacionit të Gjykatës së Lartë të Holandës, të kryesuar nga Kryetarja Dineke de Groot, e cila është vizita e parë zyrtare e këtij niveli në Shqipëri. Kjo vizitë shënoi jo vetëm afirmimin e respektit dhe interesit të ndërsjellë institucional, por edhe hapjen e një kapitulli të ri bashkëpunimi, duke vendosur themelet për shkëmbime të rregullta profesionale dhe dialog të vazhdueshëm gjyqësor. Ky bashkëpunim pritet të thellohet ndjeshëm përgjatë vitit 2026, me fokus në shkëmbimin e përvojave gjyqësore, analizën krahasimore të standardeve të vendimmarrjes, si dhe ndarjen e praktikave më të mira, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së drejtësisë dhe në forcimin e lidhjeve ndërgjyqësore europiane.

Në kuadër të përgatitjeve për organizimin e Kongresit Botëror të Ligjit në Shqipëri në vitin 2027, si një forum i rëndësishëm për diskutimin e

çështjeve globale të drejtësisë dhe për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes iniciativave të reja në këtë fushë, Gjykata e Lartë parashikon të bashkëorganizojë një aktivitet paraprak në pranverën e vitit 2026, i cili do të shërbejë si Sesion Hapës i Kongresit. Parapërgatitjet për këtë event dhe të tjerë që do ta ndjekin deri në finalizimin e zhvillimit të Kongresit në Tiranë, janë ndjekur me kujdes nga sektori në mënyrë që të garantohet një përfaqësim dhe organizim i denjë.

Përgjatë vitit 2025, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë ka ofruar asistencë në organizimin, koordinimin dhe zhvillimin e takimeve me Ambasadorë dhe përfaqësi diplomatike të huaja në Shqipëri, me qëllim ndërtimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe promovimin e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë. Disa nga aktivitetet kryesore janë takimet me Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, Ambasadorin dhe përfaqësues të OSBE-së, si dhe takime me Presidentin e Shoqatës Botërore të Ligjit dhe Kryetaren e Fondacionit Botëror të Ligjit.

Prioritet mbetet zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe afatgjata me partnerë ndërkombëtarë, përfshirë institucione rajonale, evropiane dhe globale. Objektivat për vitin 2026 përfshijnë realizimin me sukses të aktiviteteve ndërkombëtare që promovojnë standarde të larta profesionale dhe institucionale, identifikimin e mundësive të reja bashkëpunimi, si dhe avancimin e projekteve dhe partneriteteve ekzistuese.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Me vendimin nr.1, datë 21.01.2021 është miratuar struktura e re e Gjykatës së Lartë, e cila është ndryshuar me vendimet e mëvonshme të Këshillit të Gjykatës, konkretisht, vendimin nr. 84, datë 11.03.2021, vendimin nr.72, datë 23.02.2022 dhe vendimin nr.4, datë 02.03.2022, vendimin nr.20, datë 27.09.2023 dhe vendimin nr.16, datë 19.09.2024 sipas të cilave kjo Gjykatë ka në përbërje 151 punonjës (nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të tjerë), strukturë organizative e miratuar nga KLGJ. Organizimi i strukturave administrative të Gjykatës së Lartë është bërë mbi baza drejtorie, në përbërje të të cilave, në varësi të secilës drejtori është një përgjegjës dhe numër i caktuar specialistësh (me status nëpunësi civil gjyqësor) ose me disa punonjës shërbimi (me kontratë pune). Kjo qasje mundësoi inkuadrimin e dy a më shumë sektorëve në një drejtori, bazuar në kriteret e afërsisë së natyrës së aktivitetit mes sektorëve që ofrojnë shërbimet e parashikuara në ligj, përfshirja e disa shërbimeve të ngjashme ose të përafërta në një njësi duke mundësuar shfrytëzimin më të mirë të burimeve njerëzore. Konkretisht kjo strukturë ka përmbushur këto funksione dhe detyra:

- Përgatitjen e përshkrimit e punës për NCGJ dhe punonjësit administrativë të gjykatës, në përputhje me përshkrimet standarde të punës të miratuara nga KLGJ;
- Publikimin dhe shpalljen e konkurrimit të hapur për vendet e lira në SHCGJ, fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele, të cilat kanë qenë në numër të konsiderueshëm për shkak të vakancave të paplotësuara në vite;
- Ndjekjen, në përputhje me Kodin e Etikës në Gjykatën e Lartë, të disiplinës

për kohën e punës dhe të pushimit të punonjësve; kryerje e detyrave të Autoritetit Përgjegjës në bazë të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe të Njësisë Përgjegjëse në bazë të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, etj.

- Ndjekjen e zbatimit të statusit të nëpunësit civil gjyqësor për sa i përket rekrutimit, sipas procedurave përkatëse bazuar në vendim nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, të masave disiplinore dhe administrimit të dosjeve personale të punonjësve të gjykatës, etj.

Rekrutimet e bëra gjatë vitit 2025 janë bërë konform përcaktimeve ligjore të bazuar në vendimin nr.622, datë 10.12.2020 dhe vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të KLGJ-së, sipas procedurave përkatëse, në respektim të kriterëve të vendosura për secilin vend vakant të shpallur sipas normave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi për secilën kategori të punonjësve të Gjykatës së Lartë dhe duke respektuar parimet e shërbimit civil gjyqësor të mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit dhe përgjegjshmërisë. Rekrutimet e bëra nga Këshilli i Gjykatës për sa i përket shërbimeve gjyqësore, shërbimeve administrative dhe shërbimeve mbështetëse gjatë vitit 2025 përfshijnë: nëpunës civilë gjyqësor të kategorisë së mesme drejtuese; nëpunës civilë gjyqësor të kategorisë ekzekutive dhe punonjës mbështetës.

Bazuar në procedurat e rekrutimit janë kryer rekrutimet si më poshtë:

<i>Procedura</i>	<i>Numri i Rekrutimeve</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Drejtoria</i>
<i>Pranim në shërbimincivil gjyqësor</i>	4	Specialist arkive Specialiste shërbimesh mbështetëse Specialiste të ruajtjes së rendit dhe sigurisë	DadmGJ. Drejtoria e BNJSHMB Drejtoria e IT dhe Sigurisë
<i>Ngritje në detyrë</i>	1	Përgjegjës sektori i shërbimeve mbështetëse dhe prokurimeve	Drejtoria e BNJSHMB

Krahas rekrutimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë gjatë vitit 2025 janë rekrutuar dhe 2 (dy) punonjësë mbështetës, në sektorin e shërbimeve mbështetëse dhe prokurimeve, DBNJSHMB: punonjëse pastrimi dhe shofer gjyqtari

Në vitin 2025 ajo që vlen të theksohet, është komandimi në Njësinë e Shërbimit Ligjor i 5 (pesë) ndihmësmagjistratëve nga KLGJ-ja me vendimet përkatëse, duke e çuar numrin e Këshilltarëve Ligjorë në këtë njësi në 30 këshilltarë ligjorë/ndihmësmagjistratë, prej të cilëve 11 janë ndihmësmagjistratë dhe 19 janë këshilltarë ligjorë. Sfidë për vitin 2026 është plotësimi i 8 (tetë) vakancave në Njësinë e Shërbimit Ligjor, me ndihmësmagjistratë të komanduar nga

KLQJ, pasi sipas vendimit nr.1, datë 12.09.2024 i Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve u u vendos që numri i Këshilltarëve Ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor të jetë 38 këshilltarë ligjorë/ndihmësmagjistratë. (sipas vendimit nr.15, datë 21.01.2025 “Mbi miratimin e detajimit të punonjësve shtesë për vitin 2025 në sistemin gjyqësor” të KLGJ-Së struktura organizative e miratuar në NJSHL është 35 KL.)

Fundviti i 2025 e gjen Gjykatën e Lartë me 23 vakanca që priten të plotësohen gjatë 2026 , vakanca si në Trupën Gjyqësore ashtu edhe në njësitë e tjera organizative, të pasqyruara si vijon:

Trupa Gjyqësore	Kancelar	NJSHL	DAdmGJ	DMPJ	Drejtoria e BNJSHMB	Drejtoria e AdBMF
2	1	8	3	2	4	3

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe e Shërbimeve dhe kryesisht sektori i Burimeve Njerëzore në detyrat e përfshira për 2025, krahas të tjerave, do të ketë edhe përfundimin e vlerësimit të veprimtarisë së punonjësve sipas nenit 65 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe informimi i vazhdueshëm i Këshillit të Gjykatës për nevojat dhe domosdoshmërinë e plotësimit të vakancave në njësitë organizative për një veprimtari administrative dhe administrativo-gjyqësore sa më efëiente.

Drejtoria e Administrimit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Gjatë vitit 2025, Gjykata e Lartë ka bërë planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e treguesve të buxhetit të miratuar në përputhje me objektivat e përcaktuara, duke zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fuqi. Analizat e vlerësimeve të vazhdueshme si dhe monitorimet e performancës së realizimit të fondeve buxhetore i kanë shërbyer procesit të planifikimit dhe të buxhetit.

Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë për këtë periudhë është në shumën 431797 mijë lekë. Gjithashtu gjate kësaj periudhe kemi fond të çelur në art. 606 “ transferta për buxh familjar dhe individë ” shumën 717 mijë lekë.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Gjykatës së Lartë si dhe realizimi i tyre është 380453 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Fakti viti 2024	Buxheti viti 2025		Fakti i vitit 2025	Diferenca Plan-Fakt	Realizimi në %
			Plani fillestar	Plani rishikuar gjatë vitit			
600	Paga	292868	320000	292123	292123	0	100%
601	Sigurime Shoqërore	33881	44800	34791	34791	0	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	54755	60400	48400	47036	1364	97%

606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	1306	240	718	630	88	91%
	<i>Shpenzime Korrente</i>	382810	425440	376032	374580	1452	
230	Kapitale të Patrupëzuara					0	
231	Kapitale të Trupëzuara	3487	5880	4421	4421	0	100%
	Shpenzime Kapitale	3487	5880	4421	4421	0	
	<i>Shpenzime nga të ardhurat</i>					0	
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga të ardhurat)	386297	431320	380453	379001	1452	99%

Po t'i referohemi tabelës shohim se gjatë kësaj periudhe kemi mosrealizim 1452 mijë lekë me planin e parashikuar që do të thotë një përdorim shumë i mirë i fondeve. Sipas artikujve kemi realizim 100% në art. 600 “Paga” dhe art. 601 “Sigurime Shoqërore”. Në art.602 kemi një diferencë mos realizimi në shumën prej - 1452 mijë lekë.

Në zërin Shpenzime për mallra e shërbime, gjatë vitit 2025 janë planifikuar dhe realizuar me procedure prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” në menyrë elektronike si dhe me procedure “me vlerë nën 100 mijë lekë”: mirëmbajtje pajisjeve elektrike dhe hidraulike në shumën 213 mijë lekë, larje makinash 864 mijë lekë , mirëmbajtje ashensori 294 mijë lekë , blerje shtypshkrime 1282 mijë lekë, blerje uniforma

284 mijë lekë, material pastrimi 396 mijë lekë, siguracion mjete transporti 1570 mijë lekë, mirëmbajtje godine 97 mijë lekë, blerje goma makine 294 mijë lekë, etj, për të cilat janë lidhur kontrata respektive me afat deri 31.12.2025.

Shpenzime për honorare për anëtarët e KED-it gjatë vitit 2025 janë në shumën 4905 mijë lekë.

Përsa i perket realizimit të shpenzimeve në zërat e tjerë në artikullin 602, janë realizuar shpenzimet për karburant në shumën 6402 mijë lekë, taksë qarkullimi automjete në shumën 195 mijë lekë, pjesë këmbimi 2527 mijë lekë, për shërbim printimi në shumën 2858 mijë lekë.

Shpenzimet për shërbime: energji elektrike 3102 mijë, ujë 1778 mijë, telefon 2373 mijë, poste 2046 mijë etj, të cilat janë realizuar sipas planifikimit buxhetor.

Po kështu janë realizuar shpenzimet për pritje, udhëtim e dieta, kuotizacion, etj si me poshtë:

Shpenzime për pritje 92 mijë, shpenzime kuotizacioni 738 mijë, udhëtime e dieta 5954 mijë, shpenzime avokat kryesisht 43 mijë.

Për këtë vit janë vazhduar kontratat me procedure “marrëveshje kuadër” si më poshtë:

1-Mirëmbajtje mjete transporti shoqëria e shpallur fituese është operatori “*Auto servis 2000*”.

2-Shërbim printimi, shoqëria e shpallur fituese është operatori “*Infosoft Office*”

3-Blerje karburanti, shoqëria e shpallur fituese është operatori “*Gega Oil*”.

Në art 606 në këtë periudhë kemi celje fondi në “transfera tek individet” në shumën 718 mijë lekë, për “*ndihmë ekonomike dhe finaciare*” të punonjësve të institucionit si dhe kompesim të shpenzimeve celulare. Janë shpenzuar 653 mijë lekë.

Në artikullin 231 “ kapitale të trupezuara janë planifikuar:

Për Blerje Pajisje 5880 mijë lekë

Realizimi për zërin “Bleje Pajisje” është në shumën 4421 mijë lekë.

Kontratat janë realizuar të plota, brenda afateve ligjore si dhe likuidimi i detyrimeve të lindura nga këto kontrata janë bërë brenda afateve ligjore. Gjatë vitit 2025 është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe me qëllim përdorimin e fondeve me efikasitet, për përdorimin dhe menaxhimin e tyre konform rregullave dhe ligjeve në fuqi. Për vitin 2026 mbetet për tu parë planifikimi buxhetor i kërkesave të cdo drejtorie. Kërkesat duhet të jene sa më objektive nga cdo drejtori si dhe cdo fond i kërkuar duhet të përdoret nga drejtoritë përkatëse. Gjithashtu gjatë vitit 2026 në Drejtorinë e Administrimit Buxhetor dhe Menaxhimit Financiar, për shkak të përgjegjësisë së madhe dhe ngarkesës në punë, duhet të plotësohen vakancat e stafit. Realizimi buxhetor është në masën 99 % një tregues i mirë ky që flet për përdorimin e fondeve buxhetore të vëna në dispozicion të institucionit.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë

Gjatë vitit 2025, Drejtoria është angazhuar në përputhje me Rregulloren e Brendshme dhe planet e punës, në realizimin e funksioneve të saj. Në një pasqyrë të përmbledhur janë realizuar detyrat si vijojnë:

Sektori i Teknologjisë së Informacionit

Sektori i Teknologjisë së Informacionit është i angazhuar në disa detyra kryesore të caktuara me qëllim informatizimin e procesit të punës në Gjykatën e Lartë. Në bashkëpunim edhe me drejtoritë e tjera është punuar në grup për kryerjen e detyrave të drejtpërdrejta të caktuara nga Kryetari dhe Kancelari, përveç detyrave të përcaktuara nga rregullorja e brendshme e Gjykatës së Lartë. Puna e sektorit ka vijuar në punën studimore dhe kërkimore përse i përket zhvillimeve të ICMIS dhe punës mbështetëse për sektorë të tjerë. Në punën e përditshme të *sektorit të teknologjisë së informacionit* një pjesë të rëndësishme e ka zënë dhe ndjekja e realizimi i procedurave të prokurimit për departamentin e IT. Konkretisht gjatë kësaj periudhe janë realizuar:

- Mirëmbajtje sistem fonie
- Mirëmbajtje rrjeti kompjuterik
- Mirëmbajtje pajisje sigurie
- Mirëmbajtje datacenter
- Shërbimi printimit
- Mirëmbajtje faqes web

- Hostim-i i faqes së websitit të Gjykatës së Lartë
- Mirëmbajtje gjeneratori, UPS (Uninterruptible Power Supply)

Sistemi Informatik i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2025 janë zbatuar ndryshime të rëndësishme përse i përket Sistemit Informativ të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, është lidhur në fillim të vitit kontrata me shoqërinë që bën mirëmbajtjen e sistemit. Në bazë të kërkesave të përdoruesve të ndryshëm janë bërë korrigjimet e nevojshme ku përmendim:

- Shtimi i butoni exporto, para dhe pas procesit të rishortimit
- Plotësimi i procesverbaleve të dhomave të këshillimit, për të tre kolegjet nga ana e sekretarisë gjyqësore
- Është bërë e mundur përllogaritja statistikore, sipas filtrave të rinj dinamikë të kërkimit (datë vendimi, datë regjistrimi, filtrat e kombinuara)
- Shtimi i funksionaliteteve për regjistrimin dhe shortimin për seksionin KED
- Funksionalitetin e gjenerimit të raportit specifik me qëllim gjenerimin e të dhënave statistikore që lidhen mbi “gjuhën e urrejtjes
- Funksionalitetin e gjenerimit të raportit specifik me qëllim gjenerimin e të dhënave statistikore për çështjet gjyqësore të kategorizuara me objekt “*urgent*”

U shtuan përdoruesit përkatës; gjyqtarë, këshilltarë ligjorë sekretarë gjyqësorë të rinj në sistem, si dhe gjatë vitit i është dhënë mbështetje të gjithë përdoruesve të sistemit dhe janë rregulluar gabimet gjatë hedhjes së të dhënave në sistem, bazuar në urdhrat e dhënë nga Kancelari. Çdo ditë bëhet ruajtja e të dhënave të

serverit. Nga ana jonë është bërë e mundur ngritja e një serveri që replikon në kohë reale me serverin aktual (*disaster recovery plan*).

Përditësimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë

Faqja zyrtare e Gjykatës:

245.200 vizitorë unikë

22,475 vizita në ditë




Gjatë vitit është bërë përditësimi i faqes së internetit me kategori të reja, sipas nevojave të secilit Kolegj.

Çdo lloj vendimmarrje e Kolegjeve pasqyrohet në kohë reale sapo zbardhen.

Në faqen e internetit janë hedhur të gjithë njoftimet për median dhe publikun, të aktiviteteve të zhvilluara në Gjykatën e Lartë gjatë gjithë vitit. Çështjet e regjistruara nga sekretaria shfaqen automatikisht në faqen e internetit pasi çdo ditë bëhet përditësimi i faqes me të dhënat e sistemit. Gjithashtu në faqen e internetit kemi një mesatare mujore prej 245,200 vizitorëve unikë dhe 22,475 vizita në ditë. Kjo tregon se faqja e internetit e Gjykatës së Lartë i vjen në ndihmë publikut për marrjen e informacionit në kohë sa më të shpejtë, lidhur me çështjet që janë regjistruar dhe shqyrtohen në dhoma këshillimi apo seanca gjyqësore.

Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë janë shtuar dhe përditësuar periodikisht hapësirat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Çdo vendimmarrje e këtij organi, procesverbal apo njoftim pasqyrohen në këtë hapësirë në kohë reale nga ana e specialistëve të këtij sektori. Programi i Transparencës është një dritare më vete në faqen zyrtare të GjL e cila zë një hapësirë të madhe me informacion dhe kërkon kohë, angazhim, përditësim.



Gjatë gjithë vitit 2025 janë asistuar të gjithë punonjësit që kanë patur probleme të ndryshme gjatëpunës së përditshme të tyre, në lidhje me pajisjet elektronike si dhe me programet përkatës të instaluar në kompjuterë. Punonjësit janë asistuar dhe gjatë reformatimit të zyrave në Gjykatë.

Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është shtuar dhe hapësira JUDIX, që është arkiva elektronike e vendimeve të përzgjedhura të Gjykatës, me qëllim lehtësimin e kërkimit të tyre nga të gjithë përdoruesit e interesuar. Është bërë e mundur regjistrimi dhe identifikimi i administratës nga stafi i IT-së.

Në vitin 2025, sistemet informatike janë modernizuar dhe përmirësuar për të siguruar një infrastrukturë më të qëndrueshme dhe efikase. Investimet në sigurinë e sistemeve kanë përmirësuar mbrojtjen kundër kërcënimeve të mundshme dhe sulmeve të kiberkriminalitetit. Përdorimi i teknologjive të enkriptimit ka rritur nivelin e sigurisë dhe ka mbrojtur të dhënat juridike nga akseset e paautorizuara. Ka vijuar procesi i digjitalizimit të dokumenteve dhe të dhënave nëpër gjykata. Kjo ka shpejtuar procedurat gjyqësore, duke lehtësuar punën e administratës dhe rritur efikasitetin.

Gjatë gjithë vitit 2025 janë asistuar të gjithë punonjësit që kanë patur probleme të ndryshme gjatë punës së përditshme të tyre, në lidhje me pajisjet elektronike si dhe me programet përkatës të instaluar në kompjuterë. Punonjësit janë asistuar dhe gjatë riformatimit të zyrave në Gjykatë. Është bërë i mundur konfigurimi i numrave telefonik të brendshëm edhe të jashtëm në central sipas rastit ose pas lëvizjeve nëpër zyra të reja, si dhe mirëmbajtja e tij.

Për vitin 2026, një nga synimet kryesore është forcimi i kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore përmes krijimit dhe zbatimit të një programi vjetor të strukturuar trajnimit. Ky program do të fokusohet në përdorimin e inteligjencës artificiale në punën juridike, rritjen e nivelit të higjienës kibernetike, si dhe në përdorimin efektiv dhe të standardizuar të sistemeve digjitale të gjykatës. Paralelisht, do të vijojë modernizimi i infrastrukturës teknologjike, përmes zëvendësimit të pajisjeve të amortizuara dhe të vjetruara, si dhe standardizimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës sipas profileve funksionale, me qëllim rritjen e eficiencës, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit.

Një tjetër objektiv prioritar për vitin 2026 mbetet rritja e nivelit të sigurisë kibernetike të sistemeve gjyqësore. Në këtë kuadër, parashikohet realizimi i një auditimi të plotë të sigurisë për sistemet kritike, përmirësimi i protokolleve të rezervimit të të dhënave dhe të planeve të rimëkëmbjes në rast emergjencash (backup dhe disaster recovery), si dhe zhvillimi i trajnimeve periodike për stafin në lidhje me rreziqet e phishing-ut dhe praktikatat e mira të higjienës kibernetike. Njëkohësisht, synohet vendosja e mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm 24/7 të sistemeve, si dhe krijimi i sistemeve të automatizuara të alarmimit për identifikimin dhe parandalimin e sulmeve të mundshme kibernetike, në funksion të garantimit të integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së të dhënave gjyqësore.

Sektori i Sigurisë

Garantimi i sigurisë së brendshme
Zbatimi i rregullave të solemnitetit
Evidenca ditore për prezencën në punë
Regjistrimi i Hyrje– Daljeve
Lëvizja e sigurt e dosjeve gjyqësore

Gjatë vitit 2025, Sektori i Sigurisë ka realizuar me përpikmëri detyrat funksionale, ka ndjekur dhe zbatuar rregullat për garantimin e sigurisë së brendshme, dhe solemnitetin e zhvillimit të seancave publike gjyqësore, me pjesëmarrjen e palëve që nga moment i ardhjes së tyre deri në përfundimin e seancës dhe shoqërimin e tyre jashtë mjedisit të gjykatës, si është angazhuar në kryerjen e shërbimeve të ndryshme brenda institucionit.


Gjatë këtij viti është bërë i mundur realizimi i kushteve të reja për Sektorin e Sigurisë dhe është vënë në efikasitet të plotë sistemi i hyrje-daljeve me kartën

elektronike të punonjësve të gjykatës, si dhe të të gjithë personave që paraqiten për shërbime të ndryshme.

Për vitin 2026, objektivat kryesore në fushën e sigurisë synojnë forcimin e mëtejshëm të sigurisë fizike, teknologjike dhe operacionale të gjykatës, përmes modernizimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të proceseve të menaxhimit. Në këtë kuadër, parashikohet modernizimi i sistemit të hyrje-daljeve përmes teknologjive elektronike dhe biometrike, rritja e mbulimit me kamera sigurie, përmirësimi i ndriçimit dhe vendosja e barrierave fizike në pikat e aksesit, si dhe digjitalizimi i monitorimit të dosjeve dhe i sistemeve të mbikëqyrjes. Njëkohësisht, synohet azhurnimi i sistemeve elektronike të kontrollit të aksesit dhe vendosja e mekanizmave të integruar të alarmimit, me qëllim garantimin e reagimit të shpejtë dhe efektiv ndaj situatave të rrezikut.

Paralelisht me përmirësimet infrastrukturore dhe teknologjike, objektivat për vitin 2026 fokusohen në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe procedurale. Kjo përfshin shtimin dhe trajnimin e stafit të sigurisë në menaxhimin e konflikteve, situatave emergjente, sigurinë kundër zjarrit, evakuimin dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe hartimin dhe përditësimin e protokolleve të brendshme për menaxhimin e publikut, fluksit gjatë seancave dhe trajtimin e incidenteve. Në të njëjtën kohë, synohet forcimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera kompetente në fushën e sigurisë, me qëllim rritjen e koordinimit ndërinstitutional dhe garantimin e një mjedisi të sigurt, funksional dhe të qëndrueshëm për ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore.

Drejtoria e Administrimit Gjyqësor




Sektori i regjistrimit të çështjeve

Për vitin 2025 zyra e regjistrimit të çështjeve ka regjistruar 2525 dosje gjyqësore (1000 administrative, 737 civile dhe 788 penale), për të cilat janë verifikuar dhe konstatuar edhe të metat e rekursit, si një risi që sollën ndryshimet ligjore në maj 2021.

Janë listuar dhe shpërndarë në kohë të gjitha kërkesat e përsheptimit tek këshilltarët ligjorë si dhe tek gjyqtarët relator (gjithsej 552 kërkesa).

Sekretaria gjyqësore



Sekretaria gjyqësore ka pasur një volum të madh pune duke mbyllur administrativisht 6876 çështje gjyqësore dhe përmbushur të gjitha detyrat ligjore (mbajtja e procesverbalit, komunikimet nominale për gjykime si në dhomë ashtu edhe për në seancë gjyqësore, dërgimin e dosjeve në gjykatat më të ulëta, komunikimi i vendimeve palëve ndërgjyqëse, pavarësisht kohës së regjistrimit, etj.).

Për periudhën kohore 2025, janë bërë rreth 879 shkresa për kthimin e rekurseve, kundër-rekurseve, ankime të veçanta, kërkesa për heqje dorë nga rekursi, kërkesa për rishikim, kthim përgjigje/dhënie informacioni palëve ndërgjyqëse., etj.

Një problematikë e cila vazhdon të jetë prezent edhe në vitin 2025 është ardhja e dosjeve me rekurse të ushtruara në vitet 2021-2022 (kryesisht nga Zyra e Shërbimit Gjyrokastër dhe Vlorë), një pjesë e të cilave kthehen sërish administrativisht duke i mohuar kështu palëve ndërgjyqëse të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm.

Problematikë tjetër është kthimi administrativisht i dosjeve të cilat paraqiten për regjistrim, kryesisht për shkak të moskomunikimit të rekurseve palëve ndërgjyqëse, mungesë vendim pranim rekursi, etj. Gjatë vitit 2025, janë kthyer administrativisht 205 dosje për plotësim të veprimeve administrative.

Referuar ndryshimeve ligjore të vitit 2021 janë konstatuar për 87 çështje gjyqësore

administrative dhe civile me të meta rekursi (mosnënshkrim/mungesë prokurë të avokatit). Sektori i regjistrimit ka përmbushur gjithë detyrat e parashikuara në kohë dhe me saktësi, por nëse gjithë lista me ndryshimet e kërkuara në lidhje me kriteret e regjistrimit drejtuar sektorit të informatikës do të pasqyrohen në sistem, atëherë procesi i regjistrimit të dosjeve do të shkurtohet si dhe statistikave do të gjeneroheshin shumë shpejt dhe saktë. Një pjesë e nëpunësve të sekretarisë gjyqësore dhe të regjistrimit të çështjeve ka qenë edhe këtë vit e përfshirë në veprimtarinë e KED, sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga KED.

Përsa i përket gjenerimit të të dhënave statistikore, shikohet si domosdoshmëri perfeksionimi i sistemit elektronik për të përmirësuar aksesin në të gjithë të dhënat e kërkuara.

PËRFUNDIME

Viti 2025 vijoi të paraqiste sfida për Gjykatën e Lartë, duke reflektuar një realitet kompleks ku dinamika e ngarkesës së çështjeve, presioni publik dhe nevoja për rritjen e besimit të qytetarëve në drejtësi u ndërthurën me detyrimin për të garantuar pavarësi, paanshmëri dhe efikasitet në ushtrimin e funksionit kushtetues të gjyqimit. Stoku i lartë i çështjeve që vijon të përcillet ndër vite mbeti një prej shqetësimeve qendrore, i rënduar më tej nga ndërprerja e papritur e mbështetjes së disa projekteve ndërkombëtare, si pasojë e ndryshimit të politikave të partnerëve strategjikë. Kjo solli një ngarkesë të menjëhershme mbi kapacitetet e brendshme të filtrimit dhe si pasojë të gjyqimit, duke e bërë edhe më urgjente nevojën për rritjen e burimeve njerëzore, veçanërisht në Njësinë e Shërbimit Ligjor, ku përforcimi me këshilltarë të mjaftueshëm është thelbësor për përgatitjen në kohë të çështjeve dhe përshpejtimin e vendimmarrjes.

Në këtë kuadër ritheksohet sërish nevoja lidhur me shtimin e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë (deri në raportin 1 gjyqtar me 3 këshilltarë), si dhe mundësia e rritjes së përkohshme të numrit të gjyqtarëve, si masa të domosdoshme për përballimin e ngarkesës dhe për të parandaluar krijimin e stokeve të reja. Po ashtu, praktikat më të suksesshme ndërkombëtare tregojnë se krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të filtrimit përmes strukturave të posaçme ose brenda kolegeve ekzistuese përbën instrument të rëndësishëm për menaxhimin strategjik të çështjeve, rritjen e koherencës së jurisprudencës dhe nxjerrjen në pah të çështjeve me rëndësi të lartë publike apo ligjore. Megjithatë për të realizuar këtë ndërmarrje do të duhej një mbështetje reale në rritjen e stafit administrativ dhe trajnimin e specializuar të tij për të qenë një ndihmë cilësore në proceset e punës që lidhen me regjistrimin e rekurseve.


Gjithashtu, Gjykata e Lartë u përball gjatë vitit edhe me një klimë të fortë presioni mediatik dhe publik, e cila u përballua me qasje të kujdesshme institucionale dhe transparencë të shtuar. Mbrojtja e integritetit të gjyqtarëve dhe rinovimi i marrëdhënies së besimit me qytetarët mbeten sfida themelore, të cilat kërkojnë masa të qëndrueshme për forcimin e sigurisë gjyqësore, transparencën dhe komunikimin institucional.

Në planin infrastrukturor, zgjidhja e mungesave të akumuluara ndër vite dhe përshtatja e mjeteve të punës me kërkesat e teknologjisë moderne mbeten prioritet të domosdoshme për funksionimin efikas të Gjykatës së Lartë. Krijimi i kushteve të denja të punës për gjyqtarët dhe stafin ndihmës është jo vetëm kërkesë funksionale, por edhe pjesë integrale e rolit kushtetues që institucioni mban si instanca më e lartë gjyqësore në vend.

Në përmbledhje, viti 2025 u karakterizua nga sfida të vazhdueshme nga njëra anë, por edhe nga hapa të qartë dhe konkret për të qenë funksional pavarësisht vështirësive. Modernizimi institucional, rritja e kapaciteteve dhe konsolidimi i bashkëpunimit ndërkombëtar mbeten objektive strategjike, të cilat kërkojnë vijimin e mbështetjes institucionale, forcimin e burimeve njerëzore, investime në infrastrukturë dhe një qasje të përhershme të bazuar në integritet, pavarësi dhe përgjegjshmëri. Gjykata e Lartë mbetet e përkushtuar t'i adresojë këto sfida me profesionalizëm dhe të vijoje të ushtrojë misionin e saj si garant i ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri.

JANAR 2026

Një vit në foto
A year in photos



2025

Konferenca e XV e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore XV Conference of Chief Justices of Supreme Courts of Central and Eastern Europe

Vlorë, Shqipëri - 9 –10 Qershor 2025

Gjykata e Lartë e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin CEELI dhe me një delegacion gjyqtarësh nga Shtetet e Bashkuara, organizuan edicionin e XV të kësaj konference vjetore. Konferenca mbledhi bashkë Kryetarë e gjyqtarë nga 12 Gjykata të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore duke ofruar një platformë të rëndësishme për diskutime mbi pavarësinë e gjyqësorit, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal/The Supreme Court of Albania, in cooperation with the CEELI Institute and a delegation of judges from the United States, organized the 15th edition of this annual conference. The conference brought together Presidents and judges from 12 Supreme Courts of Central and Eastern Europe, providing an important platform for discussions on judicial independence, the rule of law, and regional cooperation.




Takime të rëndësishme me homologë Important meetings with counterparts

Romë, 23.01.2025 – Gjykata e Lartë e Shqipërisë dhe Gjykata e Lartë e Kasacionit të Italisë, përmes kryetarëve Sokol Sadushi dhe Margherita Cassano, nënshkruan në Romë marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e lidhjeve dhe shkëmbimin e përvojës./The Supreme Court of Albania and the Supreme Court of Cassation of Italy, through their Presidents Sokol Sadushi and Margherita Cassano, signed in Rome a cooperation agreement to strengthen ties and exchange experience.



Tiranë, 29.09.2025 – Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi, priti Kryetaren e Gjykatës së Lartë të Holandës, Dineke de Groot. Takimi synoi të nxistë dialogun institucional dhe shkëmbimin e përvojave mes dy gjykatave./The President of the Supreme Court of Albania, Sokol Sadushi, welcomed the President of the Supreme Court of the Netherlands, Dineke de Groot. The meeting, aimed to promote institutional dialogue and the exchange of experiences between the two courts.



Takime me ndërkombëtarë Meetings with international representatives

Tiranë, 28.02.2025 – Gjykata e Lartë priti një delegacion të Shoqatës Botërore të Juristëve dhe Fondacionit Botëror të Ligjit, kryesuar nga Presidenti i WJA, z. Javier Cremades García./The Supreme Court welcomed a delegation from the World Jurist Association (WJA) and the World Law Foundation (WLF), led by the President of WJA, Mr. Javier Cremades García.



Tiranë, 20.11.2025 Anette Kramme, anëtare e Bundestag-ut Gjerman u prit në një takim nga Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi dhe Zëvendëskryetari Ilir Panda./Anette Kramme, Member of the German Bundestag, was received in a meeting by the President of the Supreme Court, Sokol Sadushi, and the Vice President, Ilir Panda.



Santiago, Kili 04.04.2025 – Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pati një takim të veçantë me Kryetarin e Gjykatës së Lartë të Kilit, z. **Ricardo Blanco Herrera**./The President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, held a special meeting with the President of the Supreme Court of Chile, Mr. Ricardo Blanco Herrera.



Tiranë, 22.10.2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi, priti Drejtoreshën Ekzekutive të Fondacionit Botëror të Ligjit, Angela Montoya./The President of the Supreme Court, Sokol Sadushi, welcomed the Executive Director of the World Law Foundation, Angela Montoya.



Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare Participation in international conferences

Santo Domingo | 4-6 Maj 2025

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë merr pjesë në Kongresin Botëror të Ligjit 2025, organizuar nga World Jurist Association, një nga forumet më të rëndësishme globale në fushën e drejtësisë./The Supreme Court of the Republic of Albania is participating in the 2025 World Law Congress, organized by the World Jurist Association, one of the most important global forums in the field of justice.



Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare Participation in international conferences

Hague, Holland 17-18.03.2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi mori pjesë në Seminarin e V të **ACA-Europe** organizuar nga Këshilli i Shtetit Holandez dhe atij të Belgjikës./The President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, participated in the 5th ACA-Europe Seminar, organized under the Swedish-Finnish Presidency in The Hague by the Council of State of the Netherlands and that of Belgium.



Santiago, Kili | 2-4 Prill 2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë, Z. Sokol Sadushi, merr pjesë në Kongresin XV të shoqatës **IASAJ**. Në këtë aktivitet, shoqërohet nga anëtari i Gjykatës së Lartë, z. Gentian Medja. /The President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, is participating in the 15th IASAJ Congress, accompanied at this event by the Supreme Court Justice, Mr. Gentian Medja.



Helsinki, Finlandë | 26-27 maj 2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, mori pjesë në Konferencën e organizuar nga ACA-Europe dhe Gjykata e Lartë Administrative e Finlandës./Within the framework of its membership in ACA-Europe, the President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, participated at the conference organized by ACA-Europe and the Supreme Administrative Court of Finland



4 Nëntor 2025 Hagë, Holandë - Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, po merr pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Bashkimit Evropian/The President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, is participating in the Conference of Presidents of the Supreme Courts of the European Union.



Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare Participation in international conferences

Riyadh, Mbretëria e Arabisë Saudite, 23–24.11.2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi mori pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare për Drejtësinë, shoqëruar nga anëtarët e Gjykatës së Lartë Artur Kalaja dhe Sokol Binaj/President of the Supreme Court, Sokol Sadushi, participated in the Second International Conference on Justice, accompanied by Supreme Court Justices Artur Kalaja and Sokol Binaj.



Athinë, Greqi 10-11.11.2025 – Anëtarët e Gjykatës së Lartë, Ilir Panda dhe Valbon Çekrezi marrin pjesë në Konferencën e organizuar nga ACA-Europe dhe Këshilli i Shtetit të Greqisë./Within the framework of its membership in ACA-Europe, the members of the Supreme Court, Ilir Panda and Valbon Çekrezi, are participating in the Conference organized by ACA-Europe and the Council of State of Greece.



Takime me trup diplomatik 2025 Meetings with the diplomatic corps 2025

Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës, Sh.T.Z. Gabriel Cremades Ventura



Ambasadori i Prezencës së OSBE-së z. Michel Tarran



Trajnime dhe Aktivitete Trainings and Activities

Tiranë 5-6.02.2025 - Këshilltarë ligjorë dhe Qendra e Dokumentacionit morën pjesë në një trajnim dyditor në teknikat e hulumtimit dhe hartimit të vendimeve gjyqësore./Legal advisors and the Documentation Center took part in a two-day training to improve research techniques and the drafting of judicial decisions.



Tiranë 10.04.2025 - Trajnim i përbashkët për Njësinë Ligjore të Gjykatës së Lartë në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe Zyrën Gjyqësore të Anglisë dhe Uellsit./Joint training for the Legal Unit of the Supreme Court in cooperation with the British Embassy and the Judicial Office of England and Wales.



Tiranë, 20.11.2025 - EU4Justice organizoi një trajnim të specializuar me qëllim forcimin e aftësive për hartimin e vendimeve gjyqësore ndërmjet gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë./The EU4Justice organised a specialised training to strengthen judgment-drafting skills among judges and legal advisors of the High Court.



Tiranë, 10.12.2025 – Zv.Kryetari Ilir Panda dhe gjyqtari Sandër Simoni dhanë kontributin e tyre në seminarin e zhvilluar për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut/Deputy Chair Ilir Panda and Judge Sandër Simoni contributed to the seminar held to mark International Human Rights Day.



Aktivitete të tjera Other Activities

Tiranë, 30.09.2025 - Gjykata e Lartë zgjedh Asim Vokshin, anëtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese/The Supreme Court elects Asim Vokshi as the new member of the Constitutional Court.



Lisbon, Portugal 7-8 tetor 2025 Një delegacion nga Qendra e Dokumentacionit dhe Njësia e Shërbimit Ligjor zhvilloi një vizitë fokusuar në forcimin e praktikave të menaxhimit të çështjeve dhe të kërkimit gjyqësor/A delegation from the Documentation Centre concluded an exchange visit focused on strengthening case management and judicial research practices.



Tiranë, 3.10.2025 – Zv.Kryetari Ilir Panda dhe gjyqtarët e Kolegjit Administrativ morën pjesë në tryezën e rrumbullakët mbi drejtësinë administrative me temë “Perspektiva krahasuese nga Shqipëria dhe Austria”/Deputy Chief Ilir Panda dhe Judges of the Administrative College participated in the roundtable on administrative justice themed “Comparative Perspectives from Albania and Austria.”



Mbledhja e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë Meeting of the Judges of the Republic of Albania

Tiranë, 09.10.2025 - Kryetari i Gjykatës së Lartë, në ushtrim të përgjegjësiwe institucionale, thërret të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë në një mbledhje të veçantë, e cila u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas vrasjes tragjike të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Astrit Kalaja/The President of the Supreme Court, in the exercise of his institutional responsibilities, convened all judges of the Republic of Albania to a special meeting, held at the premises of the High Judicial Council, following the tragic murder of Judge Astrit Kalaja of the Appellate Court of General Jurisdiction. Fjala: <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/fjalime/fjala-e-kryetarit-te-gjykares-se-larte-ne-mbledhjen-e-gjyqtareve-date-9-tetor-2025> Deklarata - https://gjykata-media.s3.eu-central-1.amazonaws.com/DEKLARATA_E_GJYQTAREVE_TE_REPUBLIKES_SE_SHQIPERISE_1_df07a5a789.pdf



Dita e Hapur në Gjykatë Open Day at the Court

31.01.2025 - Në kuadrin e strategjive ndërsektoriale në arsim, nxënësit e gjimnazit "Ismail Qemali" morën pjesë në një ditë të hapur në Gjykatën e Lartë. Within the framework of the cross-sectoral education strategies on "Juvenile Justice" and "Legal Education for the Public," students from "Ismail Qemali" High School took part in an open day at the Supreme Court.



23.05.2025 - Në kuadër të nismës "Dita e Hapur në Gjykatë", Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë mirëpriti studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. As part of the "Open Day at the Court, the Supreme Court of the Republic of Albania welcomed the students of the Faculty of Law, University of Tirana.



Fjalime dhe intervista Speeches and interviews

Tiranë, 30 qershor 2025 – Fjalim me rastin e diplomimit të brezit të ri të magistratëve: “Integriteti gjyqësor përballë tundimit të konformizmit: Reflektime mbi guximin moral të magistratit”/Speech on the occasion of the graduation of the new class of magistrates.



Tiranë, 21 tetor 2025 – Fjalim në konferencën e organizuar me rastin e 30-vjetorit të pranimit të Shqipërisë në Këshillin e Evropës/Speech at the conference organized on the occasion of the 30th anniversary of Albania's accession to the Council of Europe.



Tiranë, 15 korrik 2025 – Intervistë ekskluzive me Kryetarin e Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi në RTSH, “9 vjet nga Reforma në Drejtësi”/Exclusive interview with the President of the Supreme Court, Mr. Sokol Sadushi, on RTSH, “9 years since the Justice Reform”.



Tiranë, 19 shtator 2025 – Fjala e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me rastin e prezantimit të Projektit “Fuqizimi i Integritetit Gjyqësor në Shqipëri”/Speech of the President of the Supreme Court on the occasion of the presentation of the “Strengthening Judicial Integrity in Albania” Project.



Fjalime/Speeches

Tiranë, 25 korrik 2025 – Prezantimi i Kodit të ri Penal. Kryetari i Gjykatës së Lartë, në fjalën e tij, theksoi rëndësinë e një reflektimi institucional dhe profesional mbi këtë draft, që duhet të udhëhiqet jo nga logjika e djeshme ndëshkimore, por nga nevoja për një drejtësi moderne, të qartë, humane dhe funksionale. In his address, the President of the Supreme Court emphasized the importance of institutional and professional reflection on this draft, which should be guided not by the punitive logic of the past, but by the need for a modern, clear, humane, and functional justice system.



Tiranë, 5 nëntor 2025 – Tryeza Konsultative për Projekt Kodin Penal. Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi, në fjalën e tij në tryezën konsultative, theksoi nevojën që reforma penale të ndërtohet mbi standarde të qarta profesionale dhe metodologjike. Consultative Roundtable on the Draft Criminal Code. In his remarks at the consultative roundtable, the President of the Supreme Court, Sokol Sadushi, emphasized the need for the criminal reform to be built upon clear professional and methodological standards.

Tiranë, 10 dhjetor 2025 – Fjalimi i Kryetarit të Gjykatës së Lartë me titull: Mirëqenia e magistratit - themeli i një drejtësie të besueshme/The speech of the President of the Supreme Court entitled: “The Well-being of Magistrates – the Foundation of a Trustworthy Justice”



Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë mirëpret anëtarin e ri të trupës gjyqësore, z. Genti Shala

Tiranë – 16 dhjetor 2025

Në një ceremoni të posaçme, të zhvilluar në Sallën e Kolegjeve të Bashkuara, u urua fillimi i detyrës për gjyqtarin e ri, i cili u emërua anëtar i Gjykatës së Lartë duke zëvendësuar gjyqtarin Medi Bici. Gjatë ceremonisë u theksua rëndësia e forcimit të vazhdueshëm të trupës gjyqësore me magistratë që kanë dëshmuar profesionalizëm, integritet dhe përkushtim ndaj vlerave të drejtësisë./At a special ceremony held in the Hall of the Joint Colleges, the commencement of duties of the new judge was welcomed, following his appointment as a member of the Supreme Court, replacing Judge Medi Bici. During the ceremony, the importance of continuously strengthening the judicial bench with magistrates who have demonstrated professionalism, integrity, and dedication to the values of justice was emphasized.



Tiranë, 29.12.2025
Takimi i fundvitit me median/Annual meeting with the media



2025 në rrjetet sociale/2025 on social media



www.gjykataelarte.gov.al



Vizita/visit – **1,900,000 (+ 17.5%)**
Vizitorë unikë/ Unique visitor– **130,000**
Mes./ditore.Avg. per day – **5,205**
Ndërvepruar (herë) – **4, 500,000**

Ndjekës/Followers – **2,666 (+ 15.3%)**
Vizita/Visits - **275,577**
Ndërvepruar/Engaged **4,898**

LinkedIn

Ndjekës/Followers – **7,892 (+12%)**
Ndjekës të rinj/New followers – **1003**
Ndërvepruar/Engaged **444,216 h/t**
Vizitorë unikë/Unique visitors **1,048**



Përgatiti:
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun
(Median) dhe me Jashtë
Directorate of Public Relations (Media) and
External Affairs.

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë
The Supreme Court of the Republic of Albania
Rruga/St: "Ibrahim Rugova", Tirana
ida.vodica@gjykataelarte.gov.al
Dhjetor/December 2025